

# Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile

## RAPORTI PËR KOSOVË 2013

Ky projekt është financuar nga Bashkimi Europian  
nëpërmjet Instrumentit të BE-së për Ndihmën e Para-antarësimit (IPA)  
Instrumentit për Shoqëri Civile (CSF)



Ky Raport i Monitorimit është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis i shoqërisë civile në Ballkan – Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim”

**Partner udhëheqës:**

Rrjeti Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile (BCSDN)

Metropolit Teodosij Gologanov 39/II-2, 1000-Shkup, Maqedoni

Tel.: +389 (0)2 614 42 11

[www.balkancsd.net](http://www.balkancsd.net)

**Partner zbatues për Kosovë:**

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Fazli Grajqevci 4/a, 10000, Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 248 636; 248 643

[www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org)

Ky raport është shkruar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe ekipi përgjegjës i përbërë nga:


Taulant Hoxha - autor

Besnike Koçani – hulumtuese

Dren Puka – hulumtues

Rina Dragidella – ndihmës hulumtuese

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Europian dhe Trustit Ballkanik për Demokraci. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian apo Trustit Ballkanik për Demokraci.



# BALKAN CIVIL SOCIETY DEVELOPMENT NETWORK



## Acquis i shoqërisë civile në Ballkan

Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim

Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile

## RAPORTI PËR KOSOVË 2013



Projekt i financuar nga Bashkimi European

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

# Përmbajtja

---

## Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive.....	3
Hyrje.....	6
Metodologjia.....	11
Të gjeturat dhe rekomandimet.....	13
Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive .....	13
Nënfusha 1.1.: Liria a asociimit .....	13
Nënfusha 1.2.: Liritë e tjera .....	15
Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të.....	18
Nënfusha 2.1.: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre .....	18
Nënfusha 2.2.: Përkrahja shtetërore .....	19
Nënfusha 2.3.: Burimet njerëzore.....	21
Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri-shoqëri civile .....	23
Nënfusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim .....	23
Nënfusha 3.2.: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes .....	24
Nënfusha 3.3.: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve.....	26
Të gjeturat dhe rekomandimet (forma tabelore).....	29
Lista e burimeve të shfrytëzuara .....	58
Shtojca 1 – Lista e të intervistuarëve .....	60
Shtojca 2 – Pyetjet e intervistave.....	61
Shtojca 3 – Pyetëtori i hulumtimit të organizatave .....	64

# Përmbledhje Ekzekutive

## 1. Shoqëria civile dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë

**Themelimi, regjistrimi dhe funksionimi i OJQ-ve** është i rregulluar me një kornizë ligjore bazë, mirëpo zbatimi mbetet i pjesshëm, sidomos i atyre dispozitave që kanë të bëjnë me funksionimin e OJQ-ve. **Liria e tubimit dhe shprehjes** janë të garantuara me ligj dhe OShC-të në përgjithësi i gëzojnë këto të drejta, edhe pse ka raste të kohëpaskohshme të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile. Sa i përket **qëndrueshmërisë financiare të OShC-ve**, ambienti i jashtëm është pjesërisht pengues, ndërsa OShC-të kosovare vazhdojnë të mbeten shumë të varura nga fondet ndërkombëtare. Korniza ligjore i parasheh disa **lehtësira tatimore** për donatorët privat, por në përgjithësi këto lehtësira nuk prodhojnë ndonjë efekt konkret në praktikë. Përqindja e **fondeve të shoqërisë civile që vijnë nga buxheti shtetëror** është në ngritje, por nuk ka asnjë procedurë dhe kriter për programimin, përzgjedhjen, mbikëqyrjen ose vlerësimin e tyre. Politikat që promovojnë punësimin nuk i përfshijnë edhe OShC-të si sektor që mund të gjenerojë punësim, ndërsa shteti nuk stimulon punësimin ose vullnetarizmin nëpërmjet sektorit të shoqërisë civile. Në muajin korrik të vitit 2013 është miratuar **Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile**, ndërsa aktualisht janë duke u dizajnuar **trupat dhe mekanizmat** e nevojshëm për zbatimin e kësaj strategjie. Avancimi i kornizës ligjore në nivel të Qeverisë ka vendosur obligime për **konsultime me shoqërinë civile** në procesin e hartimit të politikave publike. Si rezultat, vërehet një rritje e përfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces, mirëpo kërkesat ligjore për këtë proces ende nuk zbatohen sa duhet. **Ofrimi i shërbimeve sociale nga OShC-të** është pjesë e disa nismave të cilat janë duke e trajtuar çështjen e licensimit të shërbimeve dhe ofruesëve të shërbimeve, me synim të rritjes së mundësive për OShC-të e kësaj fushe. Megjithatë, ofrimi i shërbimeve nga OShC-të vazhdon të jetë i kufizuar vetëm në disa shërbime sociale, ndërsa nuk ka **fonde, procedura dhe standarde** të cilat do ta krijonin një ambient përkrahës për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve tjera.

Sfidat kryesore në raport me fushat e Matricës kanë të bëjnë me të ardhmen e zhvillimit të shoqërisë civile: zbatimi i duhur i legjislacionit bazë për OShC si pasojë e mungesës së kuptimit të parimeve të veprimit të sektorit civil; krijimi i një sistemi të përgjithshëm të përkrahjes publike me qëllim të sigurimit të një përgjedhje, zbatimi dhe raportimi transparent dhe llogaridhënës për projektet dhe nismat e OShC-ve; shndërrimi i parimeve të bashkëpunimit të përcaktuara së fundmi në një qasje horizontale për të gjithë sektorin e administratës publike; njohja e shoqërisë civile si një sektor i cili është i aftë të ofrojë shërbime dhe hapjen e sistemit të prokurimit publik edhe për OShC-të. Shumica e këtyre sfidave janë të përfshira gjithashtu edhe në Strategjinë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, e që mund të shërbejë si një kornizë për nisma të veçanta që adresojnë çështjet specifike. Përderisa institucionet publike janë relativisht të hapura për të hartuar politika dhe legjislacion të ri, problemi qëndron te zbatimi i këtij legjislacioni. Për këtë arsye, paralelisht me propozimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin e atij ekzistues, edhe shoqëria civile edhe qeveria duhet të insistojnë në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme dhe krijimin e mjeteve të mbikëqyrjes së rregullt.

## 2. Të gjeturat kryesore

Zhvillimi i shoqërisë civile ka qenë temë diskutimi kryesisht përbrenda grupeve të vogla të shoqërisë civile, dhe vetëm kohëve të fundit kjo temë ka filluar të jetë e pranishme në diskursin e pjesës më të madhe të strukturave politike të shtetit. Gjatë pesë viteve të fundit, qëndrimi i zyrtarëve qeveritarë ndaj

zhvillimit të OShC-ve dhe dialogut civil është duke ndryshuar nga qëndrimi kryesisht indiferent dhe bashkëpunimi ad-hok e jotransparent drejt një interesimi i cili gradualisht është në ngritje, si dhe nevojës për strukturimin e bashkëpunimit me tërë sektorin. Sidoqoftë, deri më tani, çështje të veçanta të ndërlidhura me zhvillimin e shoqërisë civile janë adresuar në mënyrë të fragmentuar dhe nuk ka pasur qasje koherente nga institucionet publike. Kjo ka rezultuar në legjislacion jo të plotë, derisa ligjet dhe mekanizmat ekzistues nuk janë zbatuar siç duhet. Kapacitetet e kufizuara dhe mungesa e gatishmërisë politike kanë qenë ndër arsyet kryesore për këtë. Roli i shoqërisë civile është njohur zyrtarisht vetëm kohëve të fundit nga Qeveria dhe Kuvendi, kur edhe janë prezantuar dokumentet e para kornizë për bashkëpunim. Megjithatë, sukcesi i këtyre hapave fillestarë varet nga ndjenja e pronësisë e institucioneve publike ndaj këtyre dokumenteve, dhe kjo fillimisht do të matet përmes burimeve njerëzore dhe financiare të dedikuara për zbatimin e tyre.

Nr	6 të gjeturat kryesore të raportit.	Referenca	
1	Legjislacioni bazë për themelimin dhe funksionimin të OShC-ve është në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, mirëpo zbatimi i duhur i tij pengohet nga kapacitetet e kufizuara të institucioneve publike dhe mungesa e harmonizimit me ligjet/mekanizmat e tjerë relevant për funksionimin të OShC-ve.	<b>Fusha</b>	<b>1</b>
		<b>Nënfusha</b>	<b>1.1</b>
2	Statusi për përfitim publik ekziston, por nuk prodhon ndonjë efekt praktik. Elementet e tij bazë ekzistojnë në Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, mirëpo nuk ka mekanizma për zbatim si dhe mungon harmonizimi me legjislacionin tatimor apo ligjet tjera, e që rezultojnë në përfitime shumë të kufizuara për bartësit e statusit për përfitim publik.	<b>Fusha</b>	<b>2</b>
		<b>Nënfusha</b>	<b>2.1</b>
3	Qasja e institucioneve publike nuk kontribuon drejt qëndrueshmërisë financiare të OShC-ve. Edhe pse pjesa e fondeve publike për OShC-të është duke u rritur, nuk ka kritere, standarde dhe procedura për programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tyre.	<b>Fusha</b>	<b>2</b>
		<b>Nënfusha</b>	<b>2.2</b>
4	Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, e miratuar kohëve të fundit, siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për përmirësimin e ambientit për zhvillim të shoqërisë civile, mirëpo korniza e tanishme institucionale dhe burimet njerëzore e financiare nuk garantojnë zbatim të kënaqshëm të saj.	<b>Fusha</b>	<b>3</b>
		<b>Nënfusha</b>	<b>3.1</b>
5	Përparimet e kohëve të fundit të kornizës ligjore në nivelin qeveritar kanë përmirësuar përfshirjen e OShC-ve në hartimin e politikave, mirëpo ende mungon zbatimi i duhur si dhe standardet e definuara për konsultim.	<b>Fusha</b>	<b>3</b>
		<b>Nënfusha</b>	<b>3.2</b>
6	Përveç ofrimit të shërbimeve sociale, pjesa tjetër e ambientit për ofrim të shërbimeve kryesisht është e mbyllur për OShC-të dhe nuk u mundëson OShC-ve të bëhen ofrues të barabartë të shërbimeve.	<b>Fusha</b>	<b>3</b>
		<b>Nënfusha</b>	<b>3.3</b>

### 3. Rekomandimet kryesore për politika

Në një periudhë kur zhvillimi i shoqërisë civile është gjithnjë e më shumë prezent në diskursin e vendimmarrësve dhe shoqërisë civile, pjesët e fragmentuara të legjislacionit dhe praktikës do të duhej të vendosen në një qasje koherente strategjike dhe të adresohen horizontalisht drejt përkrahjes së zhvillimit të shoqërisë civile. Duke u bazuar në strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile të miratuar kohëve të fundit, dhe duke shfrytëzuar burimet vendore e ndërkombëtare në dispozicion, nevojitet një intervenim sistematik si në përmirësimin e kornizës institucionale dhe kapaciteteve për zbatim të legjislacionit bazik, ashtu edhe për avancimin e kornizës ligjore të fushave të ndërlidhura, siç janë sistemi tatimor, fondet publike dhe ofrimi i shërbimeve nga OShC-të.



Nr	6 rekomandimet kryesore për reformë	Referenca	
1	Kapacitetet e Departamentit për Regjistrimin e OJQ-ve dhe të agjencive tjera zbatuese (siç është Administrata Tatimore) duhet të ngriten në mënyrë që të zbatohet dhe interpretohet si duhet legjislacioni bazik dhe fiskal për OJQ-të	Fusha	1
		Nënfusha	1.1
2	Ligjet mbi tatimin duhet harmonizuar me kapitullin për Statusin për përfitim publik të Ligjit për OJQ, si dhe duhet përcaktohen përfitime konkrete për SPP	Fusha	2
		Nënfusha	2.1
3	Duhet të inicohet një sistem gjithëpërfshirës i financimit publik, duke u bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunimin me shoqërinë civile, ndërsa kriteret, standardet e procedurat që do të përcaktohen duhet të sigurojnë zbatimin transparent dhe me llogaridhënie të fondeve publike për OShC-të. Pavarësisht këtij sistemi gjithëpërfshirës, të gjitha informatat për fondet publike të dedikuara për OShC duhet të jenë transparente qysh tani.	Fusha	2
		Nënfusha	2.2
4	Paralelisht me themelimin e një njësie të veçantë për bashkëpunim me shoqërinë civile përbrenda ZQM/ZKM, duhet të ketë fonde specifike të ndara për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe aktivitete edukative e të ngritjes së kapaciteteve për nëpunësit civilë lidhur me këtë strategji.	Fusha	3
		Nënfusha	3.1
5	Legjislacioni duhet të plotësohet me standarde minimale për konsultim publik në nivelin qeveritar, të cilat do ta mbulonin tërësisht procesin e vendimmarrjes, duke filluar nga caktimi i agjendës e deri te riformulimi.	Fusha	3
		Nënfusha	3.2
6	Ligji për Prokurimin Publik duhet të ndryshohet në mënyrë që të lejojë certifikatat e regjistrimit të OJQ-ve të pranohen, ndërsa OShC-ve që ofrojnë shërbime sociale duhet t'u vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme e shumëvjeçare.	Fusha	3
		Nënfusha	3.3

#### 4. Në lidhje me projektin dhe matricën

Raport i monitorimit është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis i shoqërisë civile në Ballkan – Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim” të financuar nga BE-ja dhe Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD). Ky raport i monitorimit është i pari i llojit të tillë që do të publikohet për çdo vit për periudhën prej 48 muajve, sa së paku pritet të jetë kohëzgjatja e projektit. Monitorimi është i bazuar në Matricën e Monitorimit të ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile të hartuar nga BCSDN dhe ECNL. Ky raport është pjesë e një vargu të raporteve kombëtare që mbulojnë 8 shtete në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë<sup>1</sup>. Një raport mbi monitorimin rajonal i cili përmbledh të gjeturat dhe rekomandimet për të gjitha shtetet dhe një platformë e internetit e cila ofron qasje në të dhënat e monitorimit për secilin shtet dhe fushë gjithashtu do të jetë në dispozicion së shpejti.

Matrica e monitorimit paraqet parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është identifikuar si e domosdoshme në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe favorizues për veprimtarinë e OShC-ve. Matrica është e organizuar rreth tre fushave, secila e ndarë në nënfusha:

(1) Garancitë themelore juridike të lirive; (2) Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të; (3) Bashkëpunimi Qeveri-shoqëri civile. Parimet, standardet dhe indikatorët janë formuluar duke pasur parasysh zhvillimin dhe diversitetin nëpër shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht dhe praktikën më të mira rregullative të Bashkimit Europian dhe shteteve të Europës. Matrica ka për qëllim të definojë një situatë optimale të dëshirueshme për veprimtarinë dhe zhvillimin efektiv të shoqërisë civile, dhe në të njëjtën kohë ka për qëllim të caktojë një kornizë realiste, e cila mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke pasur parasysh që sfidat kryesore qëndrojnë te zbatimi, indikatorët janë definuar në atë mënyrë që të monitorojnë gjendjen si të kornizës ligjore ashtu edhe të zbatimit praktik.

<sup>1</sup> Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i zi, Serbia dhe Turqia.

# Hyrje

## 1. Në lidhje me raportin e monitorimit

Shoqëria civile në Kosovë përbëhet kryesisht nga organizata joqeveritare të regjistruara, përderisa format tjera të shoqërisë civile nuk janë të shumë të pranishme. Mund të gjenden vetëm disa shembuj të iniciativave të paregjistruara dhe shumica e tyre krijohen në baza ad-hok dhe nuk vazhdojnë të jenë aktive pasi të zgjidhet çështja/problemi konkret. Për më tepër - edhe pse zyrtarisht zënë vend në kuadër të definicionit të shoqërisë civile – sindikatat shihen shumë rrallë si të tilla, dhe bashkëpunimi në mes të sindikatave të ndryshme dhe pjesës tjetër të shoqërisë civile është i kufizuar, ndërsa sindikatat rrallë janë pjesë e iniciativave dhe forumeve të shoqërisë. Bashkësitë fetare, në përgjithësi, nuk konsiderohen të jenë pjesë e shoqërisë civile. Mediet bëjnë konsiderohen edhe brenda edhe jashtë këtij sektori – shumica prej tyre janë të regjistruara si biznese private, mirëpo roli i tyre në çështje specifike të demokracisë mund t'i bëjë të konsiderohen pjesë e shoqërisë civile.

Ky raport ka adresuar çështjet e shoqërisë civile në kuptimin e definuar më lartë. Sidoqoftë, iniciativat apo çështjet e veçanta të cilat nuk konsiderohen patjetër brenda shoqërisë civile janë marrë parasysh, në raste kur ato çështje apo iniciativa kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërisë civile. Ky raport përfshin periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2013.

Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi i bazës për monitorim dhe avokim në çështjet e lidhura me ambientin favorizues dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile në nivel rajonal dhe kombëtar, si dhe fuqizimi i strukturave për integrimin dhe pjesëmarrjen e OShC-ve në politikat e BE-së dhe procesin e anëtarësimit në nivel europian dhe kombëtar.<sup>1</sup>

## 2. Matrica monitoruese mbi mjedisin favorizues për zhvillim të shoqërisë civile

Ky raport i monitorimit është pjesë e aktiviteteve të “Acquis i shoqërisë civile në Ballkan – Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim” të financuar nga BE-ja dhe Trusti Ballkanik për Demokracinë (BTD). Ky raport i monitorimit është i pari i llojit të tillë që do të publikohet për çdo vit për periudhën prej 48 muajve, sa së paku pritet të jetë kohëzgjatja e projektit. Monitorimi është i bazuar në Matricën e Monitorimit të ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile të hartuar nga BCSDN dhe ECNL. Ky raport është pjesë e një vargu të raporteve kombëtare që

mbulojnë 8 shtete në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë<sup>2</sup>. Një raport mbi monitorimin rajonal i cili përmbledh të gjeturat dhe rekomandimet për të gjitha shtetet dhe një platformë e internetit e cila ofron qasje në të dhënat e monitorimit për secilin shtet dhe fushë gjithashtu do të jetë në dispozicion nga muaji Mars 2014.

Matrica e monitorimit paraqet parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është identifikuar si e domosdoshme në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe favorizues për veprimtarinë e OShC-ve. Raporti nënvizon faktin se ambienti favorizues është një koncept i përbërë i cili përshinë fusha të ndryshme dhe varet nga disa faktorë dhe etapa të zhvillimit të shoqërisë dhe të sektorit të shoqërisë civile.

Matrica është organizuar rreth tre fushave, të ndara në nënfusha:

1. Garancitë themelore juridike të lirive;
2. Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të;
3. Bashkëpunimi Qeveri-shoqëri civile..

Kjo matricë nuk ka për qëllim të

<sup>2</sup> Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i zi, Serbia dhe Turqia.



përmbledh të gjitha çështjet e ambientit favorizues, ajo më shumë i thekson ato për të cilat ekspertët kanë ardhur në përfundim që janë më të rëndësishmet për shtetet në të cilat ata veprojnë. Për këtë arsye, standardet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë parasysh gjendjen e tashme të zhvillimit dhe diversitetin e shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Këto janë nxjerrë nga përvojat e OShC-ve nëpër shtetet përkatëse, në aspektin e mjedisit ligjor si dhe praktikave dhe sfidave të zbatimit të tij. Zhvillimi i parimeve është bërë duke marrë parasysh të drejtat dhe liritë e garantuara ndërkombëtarisht si dhe praktikat më të mira në nivel të Bashkimit European dhe shteteve të Europës.

Fushat janë definuar përmes parimeve kryesore të cilat janë shtjelluar përmes standardeve specifike. Në mënyrë që t'u mundësojmë OShC-ve, donatorëve apo palëve e tjera të interesuara të shqyrtojnë dhe monitorojnë mjedisin ligjor dhe praktikat e zbatimit të tij, standardet më tutje janë shpjeguar përmes indikatorëve. Matrica e plotë është në dispozicion në kapitullin e VI. Të gjeturat dhe rekomandimet.

Zhvillimi i Matricës së monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile ishte pjesë e tentimeve të përbashkëta të ekspertëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile nga organizatat anëtare dhe partnerët e BCSDN-së, si dhe me përkrahje strategjike dhe në nivel të ekspertizës nga ECNL. Ekipi i ekspertëve i përbërë nga 11 anëtarë ka pasur shtrirje në diturinë dhe përvojën e shumëllojshme joqeveritare dhe të OShC-ve, si ligjore ashtu edhe praktike, dhe ka përfshirë ekspertë nga 10 shtete të Ballkanit. Puna në Matricë ka përfshirë punëtori dhe punë on-line me ekspertët, e cila më pastaj është shqyrtuar me kujdes nga grupe të fokusit të palëve të interesuara dhe konsultime publike. Puna në zhvillimin e Matricës është përkrahur nga USAID, Pact. Inc, dhe ICNL, në kuadër të programit për mjedisin favorizues ligjor (LEEP)/grantet për inovacione ligjore, si dhe nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD).

### 3. Shoqëria civile dhe zhvillimi i shoqërisë civile (CSDev) në Kosovë

Deri në nëntor të vitit 2013 janë regjistruar 7,452 OJQ, edhe pse vetëm rreth 10% të tyre vlerësohet të jenë ende aktive.

OShC-të kosovare mbulojnë një gamë të gjerë të fushave të aktiviteteve të tyre. Një numër i fushave gjithnjë tërheqin më shumë OShC dhe disa fusha tjera janë duke parë rënie në numrin

e OShC-vë të përfshira. Më herët, fushat kryesore të angazhimit të OShC-ve ishin të drejtat e gruas, çështjet e minoriteteve dhe të rinisë. Pas pavarësimit të Kosovës në vitin 2008, puna e OShC-ve në çështjet e demokratizimit, siç është sundimi i ligjit në përgjithësi si dhe ato OJQ që njihen si “ OJQ mbikëqyrëse” (watchdog) janë duke e rritur prezencën e tyre. Për më tepër, ka një numër mjaft të madh të OShC-vë të cilat merren me çështje specifike siç janë të drejtat e njeriut, rinia, të drejtat e gruas, mjedisi, kultura, përfshirja shoqërore, etj.

Zhvillimi i shoqërisë civile ka qenë temë diskutimi kryesisht përbrenda grupeve të vogla të shoqërisë civile, dhe vetëm kohëve të fundit kjo temë ka filluar të jetë e pranishme në diskursin e pjesës më të madhe të strukturave politike të shtetit. Gjatë pesë viteve të fundit, qëndrimi i zyrtarëve qeveritarë ndaj zhvillimit të OShC-ve dhe dialogut civil është duke ndryshuar nga qëndrimi kryesisht indiferent dhe bashkëpunimi ad-hok e jotransparent drejt një interesimi i cili gradualisht është në ngritje, si dhe nevojës për strukturimin e bashkëpunimit me tërë sektorin. Presioni i brendshëm nga OShC-të kosovare dhe theksi i vazhdueshëm që Bashkimi European e vë në rëndësinë e një sektori civil të zhvilluar ka rezultuar në ngritje të interesimit të institucioneve publike që të përfshijnë dhe të bashkëpunojnë me shoqërinë civile përmes mekanizmave dhe instrumenteve të tyre.

Konkretisht, themelimi, regjistrimi dhe funksionimi i OJQ-ve është i rregulluar me një kornizë ligjore bazë, mirëpo zbatimi mbetet i pjesshëm, sidomos i atyre dispozitave që kanë të bëjnë me funksionimin e OJQ-

ve. Liria e tubimit dhe shprehjes janë të garantuara me ligj dhe OShC-të në përgjithësi i gëzojnë këto të drejta, edhe pse ka raste të kohëpaskohshme të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile. Sa i përket qëndrueshmërisë financiare të OShC-ve, ambienti i jashtëm është pjesërisht pengues, ndërsa OShC-të kosovare vazhdojnë të mbeten shumë të varura nga fondet ndërkombëtare. Korniza ligjore i parasheh disa lehtësira tatimore për donatorët privat, por në përgjithësi këto lehtësira nuk prodhojnë ndonjë efekt konkret në praktikë. Përqindja e fondeve të shoqërisë civile që vijnë nga buxheti shtetëror është në ngritje, por nuk ka asnjë procedurë dhe kriter për programimin, përzgjedhjen, mbikëqyrjen ose vlerësimin e tyre. Politikat që promovojnë punësimin nuk i përfshijnë edhe OShC-të si sektor që mund të gjenerojë punësim, ndërsa shteti nuk stimulon punësimin ose vullnetarizmin nëpërmjet sektorit të shoqërisë civile. Në muajin korrik të vitit 2013 është miratuar Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, ndërsa aktualisht janë duke u dizajnuar trupat dhe mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e kësaj strategjie. Avancimi i kornizës ligjore në nivel të Qeverisë ka vendosur obligime për konsultime me shoqërinë civile në procesin e hartimit të politikave publike. Si rezultat, vërehet një rritje e përfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces, mirëpo kërkesat ligjore për këtë proces ende nuk zbatohen sa duhet. Ofrimi i shërbimeve sociale nga OShC-të është pjesë e disa nismave të cilat janë duke e trajtuar çështjen e licensimit të shërbimeve dhe ofruesëve të shërbimeve, me synim të rritjes së mundësive për OShC-të e kësaj fushe. Megjithatë, ofrimi i shërbimeve nga OShC-të vazhdon të jetë i kufizuar vetëm në disa shërbime sociale, ndërsa nuk ka fonde, procedura dhe standarde të cilat do ta krijonin një ambient përkrahës për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve tjera.

Faktorët të cilët e pengojnë zhvillimin e OShC-ve vijnë nga të dy anët. Pikësëpari dhe më e rëndësishmja, apatia e shprehur qytetare nuk krijon presionin e nevojshëm ndaj institucioneve publike për investimin e energjisë dhe fondeve të tyre në një ambient të favorshëm për shoqërinë civile. OShC-të, kryesisht ato të mëdha dhe profesionale, mbeten ndër të paktat të cilat krijojnë kërkesën vendore për ambient të favorshëm, derisa BE-ja është aktori kryesor i jashtëm i cili i shtyn institucionet kosovare publike që të punojnë në këtë drejtim. Sektorët tjerë, siç është sektori i biznesit, mbeten anash tentimeve për të krijuar një ambient të favorshëm për zhvillimin e OShC-ve. Edhe një faktor tjetër pengues është niveli i ulët i të kuptuarit të konceptit të shoqërisë civile dhe i potencialit të saj për ndërtimin e një shteti demokratik dhe funksional, duke përfshirë mungesën e kapaciteteve konkrete për t'i kontribuar ambientit të favorshëm. Në fund, problemet me sundimin e ligjit dhe korrupsionin, si dhe zhvillimet politike shumë dinamike janë një barrë shtesë në mbajtjen e zhvillimit të shoqërisë civile në listën e prioriteteve si qeveritare ashtu edhe të shoqërisë civile.

Derisa mungesa e gatishmërisë politike është arsyeja kryesore e cila qëndron prapa shumë vështirësive në avancimin e ambientit për veprim të OShC-ve, disa prej faktorëve janë gjithashtu rezultat i zhvillimit historik të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në Kosovë. Historia e shoqërisë civile në Kosovë është pjesë e një tregimi më të gjerë në Europën lindore gjatë rënies së komunizmit, por gjithashtu e formuar nga rrethanat unike të Kosovës dhe shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë. Pas suspendimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, shoqëria civile u bë pjesë e rezistencës paqësore, duke bashkëpunuar së afërmi me Qeverinë paralele të themeluar për t'iu kundërvënë Beogradit dhe duke ofruar shërbime shëndetësore, të mirëqenies sociale dhe të shkrimit e leximit. Sukses i Lëvizjes për pajtimin e gjaqeve është vetëm një shembull i popullaritetit dhe fuqisë së shoqërisë civile gjatë kësaj epoke.<sup>3</sup> Thujse e tërë popullata e Kosovës ishte aktive gjatë një dekade të plotë të solidaritetit shoqëror

---

<sup>3</sup> UNDP, Raporti për zhvillimin njerëzor 2008, Shoqëria civile dhe zhvillimi, f.12, [http://hdr.undp.org/sites/default/files/nhdr\\_2008\\_kosovo\\_en.pdf](http://hdr.undp.org/sites/default/files/nhdr_2008_kosovo_en.pdf)

dhe vullnetarizmit. Pas çlirimit dhe pavarësisë, motivi i lartë politik i asaj kohe nuk ekziston ndërsa ka kohë që burimet e energjia e asaj kohe janë shpenzuar.<sup>4</sup>

Shoqëria civile është përballur me ndryshime radikale pas intervenimit të NATO-s në vitin 1999 dhe përqendrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në ndërtimin e paqes dhe rindërtim, si dhe me një mori të donatorëve të huaj të cilët i kanë shtyrë OShC-të të luajnë rol të madh por gjithashtu, në disa raste, në mënyrë të fshehtë apo të hapur, kanë definuar parametrat e atij roli. Për pjesën më të madhe të periudhës së qeverisjes ndërkombëtare dhe administrimit të dyfishtë nga UNMIK-u dhe institucionet vendore gjatë viteve të 2000, shoqëria civile kryesisht është përqendruar në veprime emergjente dhe të rindërtimit, si dhe të pajtimit ndëretnik, duke pasur shumë pak angazhime me institucionet publike. Me marrjen e përgjegjësisë nga ana e institucioneve vendore dhe sidomos pas pavarësisë të Kosovës, administrata e re publike dhe mungesa e përvojës në bashkëpunimin me shoqërinë civile vazhdon të paraqet vështirësi shtesë në zhvillimin e legjislacionit dhe mekanizmave të ri, por edhe më shumë në fazën e zbatimit.

#### **4. Karakteristikat dhe sfidat specifike në zbatimin e matricës në Kosovë**

Monitorimi i gjendjes së zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë duke u bazuar në këtë matricë ka qenë një ndërmarrje mjaft sfiduese, kryesisht për shkak të zbrazëtirave të mëdha në të dhënat në dispozicion nga Agjencia e Statistikave apo institucione tjera të cilat janë kompetente për pjesë specifike të zhvillimit të shoqërisë civile. Kjo është arsyeja pse KCSF ka vendosur t'i plotësojë me njëra tjetrën dy iniciativa të njëkohëshme: Matrica e zhvillimit të shoqërisë civile dhe Indeksi Kosovar i shoqërisë civile, në mënyrë që të sigurohen të dhënat themelore të cilat janë të nevojshme për vlerësimin e gjendjes së zhvillimit të shoqërisë civile dhe ambientit në të cilin vepron ky sektor. Ndërmarrja paralele e këtyre dy iniciativave ka pasur dobitë dhe sfidat e saj. Dobitë kryesore kanë qenë se një sasi e madhe e të dhënave është mbledhur përmes përdorimit të mjeteve hulumtuese të Indeksit Kosovar të Shoqërisë Civile, gjë që përndryshe do të ishte e pamundshme për shkak të burimeve të kufizuara në dispozicion për Matricën. Në anën tjetër, kjo ka kërkuar bashkëpunim dhe planifikim të gjerë të të dyja iniciativave, pasi që grupet e synuara për mbledhjen e të dhënave kanë qenë shumë të ngjashme, dhe shfrytëzimi i tepruar i tyre do të mund të rezultonte me refuzim të kërkesës për t'u përgjigjur apo në informata të pasigurta.

Për më tepër, një sfidë shtesë ishte edhe legjislacioni i fragmentuar i cili përmban dispozita specifike relevante për zhvillimin e shoqërisë civile. Shumica e këtyre dispozitave specifike janë "të fshehura" nëpër një numër të madh të ligjeve dhe udhëzimeve administrative, dhe navigimi nëpër këtë sistem të përbërë të legjislacionit si dhe ndërlidhja e duhur e tyre ka kërkuar punë të jashtëzakonshme të hulumtimit në zyre dhe analizës.

Së fundi, zhvillimi i shoqërisë civile është një temë e cila nuk është pjesë e punës së shumicës së OShC-ve aktive në Kosovë. Kjo rezulton në numër të kufizuar të raporteve apo të dhënave në dispozicion të cilat do të mund të përdoren për këtë raport.

---

<sup>4</sup> KCSF-CIVICUS, Indeksi i shoqërisë civile, Raport kombëtar analitik për Kosovën, Qeverisje më e mirë për një ndikim më të madh, Njw thirrje për qytetarët, f.23, <https://civicus.org/downloads/CSI/Kosovo.pdf>

## 5. Mirënjohje dhe falënderime

Puna e KCSF-së në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për këtë raport ishte bazuar në punë ekipore, e që ka përfshirë pjesën më të madhe të stafit të saj dhe është ndërtuar në rezultatet e një numri të projekteve dhe iniciativave tjera të saj. Pa përkrahjen e plotë të të gjithë kolegëve nga KCSF, do të ishte e pamundur që ekipi përgjegjës për këtë raport ta përfundojë këtë detyrë. Për këtë arsye, kontributi i secilit pjesëtar të ekipit të KCSF-së vlerësohet shumë.

Për më tepër, KCSF dëshiron t'u falenderohet të gjitha atyre OShC-ve dhe përfaqësuesëve të institucioneve publike, medieve, akademikëve dhe sektorit të biznesit të cilët kanë pranuar të japin mendimet dhe opinionet e tyre përmes pyetësor dhe intervistave. Informatat e mbledhura nga një numër i madh i aktorëve të rëndësishëm për punën e shoqërisë civile në Kosovë kanë qenë vendimtare për të mbuluar shtrirjen e plotë e kësaj matrice.

Në fund, KCSF e vlerëson përkrahjen e dhënë nga Zyra Ekzekutive e BCSDN-së dhe ECNL në zhvillimin dhe zbatimin e këtij projekti monitorues. Përkrahja e tyre ka qenë një ndihmesë e madhe për t'i vendosur të gjitha informatat përbrenda një formati të definuar mirë dhe të krahasueshëm me rajonin, por në të njëjtën kohë që siguron vend të mjaftueshëm për informata specifike kombëtare.

# Metodologjia

## 1. Përmbledhje e qasjes metodologjike

Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile është zhvilluar duke u bazuar në ekspertizën dhe përvojën rajonale, dhe ka për qëllim t'i adresojë si çështjet e përbashkëta relevante të tërë Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, ashtu edhe çështjet specifike të secilit vend. Duke u përdorur si mjet monitorimi për herë të parë, metodologji të ndryshme janë përdorur në vende të ndryshme, derisa mësimet e nxjerra nga viti i parë i monitorimit do të përdoren gjatë rishikimit dhe hartimit të një metodologjie të njëtrajtshme për të ardhmen.

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, duke qenë në krye të zbatimit të Matricës për Kosovë, mori të dhënat e një projekti hulumtues paralel në lidhje me gjendjen e shoqërisë civile dhe i kombinoi mjetet për mbledhjen e të dhënave për të dyja këto procese, të cilat kryheshin në të njëjtën periudhë kohore. Konkretisht, mbledhja e të dhënave është bërë në të njëjtën kohë për Indeksin Kosovar të shoqërisë civile dhe Matricën, duke sjellë vlerë të shtuar dhe duke plotësuar gamën e çështjeve të mbuluara të secilit projekt.


Mbledhja e të dhënave është kryer duke përdorur dy lloje mjetesh: cilësore dhe sasiore. Hulumtimi i organizatave me 100 OShC ka qenë burimi kryesor i informatave për shumicën e çështjeve për të cilat janë nevojitur informata nga OShC-të. Një pyetësor i kufizuar i popullsisë me 1,300 persona që janë përgjigjur brenda tërë Kosovës ka siguruar informata të përgjithshme mbi përfshirjen në dhe perceptimin e qytetarëve ndaj shoqërisë civile në Kosovë. Metodatat sasiore janë plotësuar me intervista të thella me më shumë se 30 përfaqësues nga shoqëria civile dhe institucione publike, si dhe 30 intervista gjysëm të strukturuar me më shumë se 30 përfaqësues të të gjithë sektorëve jashtë shoqërisë civile. Në fund, një hulumtim gjithëpërfshirës i legjislacionit relevant në fuqi dhe raporteve tjera të organizatave dhe institucioneve ka shërbyer për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statike, duke shërbyer kryesisht për monitorimin e indikatorëve për pjesën e legjislacionit.

Përveç kësaj, duke ndërtuar mbi përvojën e gjerë të KCSF-së në iniciimin, dizajnimin dhe zbatimin e pjesëve të shumta të legjislacionit dhe mekanizmave për lirinë e asociimit, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile, informata dhe përvoja të brendshme janë përdorur për nënfushën 1.1. (Liria e asociimit); nënfushën 3.1. (korniza dhe praktikat për bashkëpunim) dhe nënfushën 3.2. (pjesëmarrja në proceset e vendimmarrjes dhe të hartimit të politikave).

## 2. Pjesëmarrja e OShC-ve

OShC-të kanë qenë të përfshira drejtpërdrejt në mbledhjen e të dhënave, përmes metodologjive si cilësore ashtu edhe sasiore. Hulumtimi i organizatave është kryer me 100 OShC aktive dhe ka mbuluar një gamë të gjerë të temave që kanë të bëjnë me ambientin e favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Mostra e OShC-ve ka përfshirë 10 OShC të mëdha dhe të njohura, 10 OShC të vogla (lokale), 40 OShC që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm dhe 40 OShC që përfaqësojnë rajone të ndryshme gjeografike. Për më tepër, intervistat e thella janë mbajtur me 30 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe sektorit të biznesit. Përzgjedhja e të intervistuarëve është bazuar në metodën e "informatoreve kyç", të cilët janë përzgjedhur duke u bazuar në përfshirjen e tyre në fusha të ndryshme të mbuluara nga nën-fushat specifike të kësaj matrice, duke supozuar se ata posedojnë të dhëna dhe

informata të cilat mund të shfrytëzohen nga intervistuesit. Numri i informatorëve kyç ka pasur për qëllim



të mbulojë secilën nën-fushë të matricës monitoruese. Secili grup i intervistuar ka pasur një numër të pyetjeve standarde, si dhe pyetje specifike, varësisht nga përvoja dhe fusha e tyre e ekspertizës. Pyetjet kanë pasur për qëllim mbledhjen e informatave si për legjislacionin ashtu edhe për praktikën në nën-fusha të ndryshme. Për më tepër, intervistat janë mbajtur me një fleksibilitet shtesë sa i përket temave dhe pyetjeve të mbuluara, me qëllim

që të eksplorohej thellësisht informatat e dhëna nga këta informatorë kyç. Për të plotësuar këta të fundit, metodologjia ka përfshirë edhe intervistimin e një numri të “personave të jashtëm”, kryesisht organizatave/individëve të cilët nuk janë drejtpërdrejt të ndërlidhur me nën-fushë specifike, por që mund të kenë informata apo mendime për cilindo tregues apo nën-fushë të matricës.

Lista e të intervistuarëve, pyetjet e intervistës si dhe pyetësi i hulumtimit të organizatave janë të listuara si shtojcë e këtij raporti.



# Të gjeturat dhe rekomandimet

## Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

### Nënfusha 1.1.: Liria a asociimit

Liria a asociimit është e drejtë kushtetuese e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës së Kosovës dhe e definuar në Ligjin 04/L-57 mbi Lirinë e Asociimit në OJQ. Forma ligjore të cilës i jepet kjo liri përfshin shoqatat dhe fondacionet (sipas Ligjit për OJQ), si dhe sindikatat, partitë politike, odat ekonomike, bashkësitë fetare etj.. të cilat rregullohen përmes ligjeve të tyre përkatëse. Mirëpo, nuk ka dispozita ligjore mbi themelimin e kompanive jofitimprurëse apo fondeve investive/të dhurimeve, edhe pse këto të fundit as nuk janë të ndaluara e as të lejuara në mënyrë të qartë dhe raste të fondacioneve që funksionojnë si të fonde investive/të dhurimeve mund të gjenden. Shoqatat mund të themelohen nga së paku tre persona fizik ose juridik, derisa fondacionet mund të themelohen nga një person apo përmes testamentit. Nuk ka kurrfarë kërkesash për minimumin e fondeve apo për fonde fillestare për themelimin e fondacionit, kështu që shumica e fondacioneve janë themeluar pa asnjë pronë apo aset fillestar. Regjistrimi i OJQ-

Nga 7,452 OJQ të regjistruara në dhjetor të vitit 2013, 6,947 janë vendore dhe 505 OJQ të huaja/ndërkombëtare. Nga OJQ-të vendore, 6,695 janë asociacione dhe 252 fondacione.

ve nuk është i obligueshëm, edhe pse shumica e organizatave vendosin të regjistrohen me qëllim të përfitimit të statusit ligjor. Rregullat e regjistrimit janë të thjeshta dhe pa pagesë, dhe përgjigja e Departamentit të Regjistrimit të OJQ-ve duhet të kthehet brenda 60 ditëve. Në praktikë, shumica e OJQ-ve regjistrohen përbrenda këtij afati kohor, edhe pse ka raste kur ky afat nuk respektohet, kryesisht për shkak të kërkesave për dokumentacion shtesë apo ndryshim të statutit. Edhe pse regjistrimi konsiderohet të jetë lehtë i qasshëm dhe mos pa procedura të rënduara, ka raste kur Departamenti i Regjistrimit të OJQ-ve kërkon dokumente shtesë të cilat as nuk janë kërkesë ligjore e as nuk bazohen në dokumente apo


Në vitin 2012, Parlamenti i Kosovës ka miratuar ligjin e sponsoruar nga Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Kosovës, i cili lejonte transformimin e OJQ-ve mikrofinanciare në kompani private, duke mundësuar transferim të drejtpërdrejtë të pronësisë të udhëheqësit e atyre OJQ-ve. Pas reagimit të koalicionit të OSHC-ve të cilat e kundërshtuan këtë transformim, në vitin 2013 Gjykata Kushtetuese deklaroi se të gjitha dispozitat e ndërlidhura me transformimin janë jokushtetuese.

standarde ndërkombëtare. Për shembull, ligji kërkon së paku tre persona për themelimin e një shoqate, derisa Departamenti i Regjistrimit të OJQ-ve kërkon një listë shtesë me së paku 5 anëtar të shoqatës. Një platformë për regjistrim në internet është dizajnuar para disa vitesh, mirëpo

është vënë në funksion vetëm kohëve të fundit, ndërsa regjistrimi nëpërmes internetit ende nuk është i shprehur, kryesisht për shkak të pamundësisë së vënies së vulës në dokumente përmes sistemit të internetit. Legjislacioni lejon mundësinë e ankesës, dhe një udhëzim administrativ për ushtrimin e të drejtës së ankesës ekziston. Mirëpo, është problematik fakti se po të njëjtit autoritet i është dhënë mandati ta themelojë komisionin për ankesa. Për më tepër, nuk ekzistojnë fare rregulla të qarta për funksionimin e këtij komisioni. Shumica e problemeve në fazën e regjistrimit janë për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe kuptimit të kërkesave ligjore nga Departamenti i Regjistrimit të OJQ-ve, i cili është i vetmi autoritet përgjegjës për regjistrimin e OJQ-ve.

Në përgjithësi, OShC-të në Kosovë veprojnë të lira dhe pa ndërhyrjen e pajustificuar të shtetit në qeverisje dhe aktivitete të tyre. Korniza ligjore ndalon autoritetet publike të ndërhyjnë në punët dhe aktivitetet e OJQ-ve dhe nuk është lajmëruar ndonjë rast i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të shtetit në punët e brendshme të OShC-ve. Kërkesat për raportim janë të dy niveleve: raportimi te Administrata Tatimore

për transaksionet e tyre financiare dhe raportimi Departamentit të Regjistrimit të OJQ-ve për organizata me Status të Përfitimit Publik. Kërkesat e raportimit te Administrata Tatimore janë të ngjashme me bizneset dhe 53.94% të OShC-ve të intervistuar konsiderojnë se këto kërkesa nuk janë në përputhje me natyrën specifike të punës së OShC-ve. Në anën tjetër, raportimi i organizatave me SPP (231 organizata me SPP në vitin 2013) është edhe për pjesën



programore ashtu edhe atë financiare, ndërsa organizatat me SPP me të ardhura mbi 100,000 EUR duhen gjithashtu të dorëzojnë një raport të të auditimit të jashtëm. Mirëpo raporti për pjesën programore është i bazuar në modelet të cilat nuk lejojnë informim dhe vlerësim të duhur të punës për përfitim publik të OShC-ve. Ligji 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e ka një prag më të ulët për pagesat e OShC-ve në krahasim me sektorët tjerë: OJQ-të duhen të kërkojnë leje të posaçme për pranimin e shumës më të lartë se 1,000 EUR nga një dërgues i vetëm apo për pagesë më të lartë se 5,000 EUR për një pranues të vetëm, brenda një dite. Që të jenë në gjendje të kryejnë apo pranojnë pagesa të cilat i tejkalojnë shumat e specifikuar më lartë, OJQ-ja mund të kërkojë nga Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NjIF-K) përjashtim nga këto obligime për një herë apo për një periudhë të caktuar kohore. Kërkesat me shkrim që i dorëzohen NjIF-K-së nga OJQ-ja duhen të theksojnë llojin e përjashtimit dhe arsyet për këtë përjashtim, derisa NjIF-K-ja duhet t'i përgjegjet kësaj kërkesë brenda tridhjetë (30) ditëve. Përgjigjet e NjIF-K-së mund të jenë: 1) lejohet 2) lejohet me kusht ose 3) refuzohet. Mirëpo i tërë procesi i kërkesës dhe përgjigjes nuk përmban kritere të cilat do të duhej të merren parasysh nga NjIF-K gjatë marrjes së vendimit. Kjo krijon një bazë për interpretime të ndryshme apo vendime arbitrare. Këto kërkesa janë të rënda për OShC-të pasi që ato mund të krijojnë probleme për pranimin e fondeve nga donatorët apo për pagesën e fondeve nga dhënësit vendor të granteve. Për më tepër, sanksionet për shkeljen e këtyre kufizimeve janë problematike në dy aspekte: së pari, ato nuk janë në proporcion me shkallën e shkeljes, pasi që ato lejojnë edhe shuarjen e OJQ-ve; së dyti, ato i japin Departamentit të Regjistrimit të OJQ-ve autoritetin që ta shuaj OJQ-në, e që nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ. Mirëpo, aktualisht nuk është raportuar që këto dispozita të jenë zbatuar në praktikë. Në kuadër të Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ, dispozitat ligjore për shuarjen e OJQ-ve janë në pajtim me parimet dhe standardet ndërkombëtare, edhe pse dispozitat mbi shpërndarjen e aseteve nuk janë funksionale. Ekziston një udhëzim administrativ mbi themelimin e Komitetit për shpërndarjen e aseteve të mbetura të OJQ-ve të shuara, mirëpo procedurat dhe kriteret specifike mbi vendimet nga ky Komitet nuk ekzistojnë.

Në Kosovë, OShC-të lirshëm mund të kërkojnë dhe sigurojnë burime financiare për veprimtarinë e tyre nga burime të ndryshme vendore dhe të huaja. Korniza ligjore lejon OShC-të të merren me aktivitete të ndryshme ekonomike, derisa aktivitetet e ndërlidhura ekonomike janë gjithashtu të përjashtuara nga

tatimi në fitim. Mirëpo, vetëm një numër i OShC-ve merren me aktivitete ekonomike dhe shumica e tyre nuk janë të njoftuara me obligimet dhe kufizimet përkatëse. Ngjashëm, Administrata Tatimore ka kapacitete të kufizuara për tu marrë me natyrën specifike të punës së OShC-ve, pasi që shumicën e rasteve OShC-të trajtohen ngjashëm me biznese. Pranimi i financimit të jashtëm lejohet dhe 74% të burimeve të shoqërisë civile vijnë nga donatorët ndërkombëtar.<sup>5</sup> Përveç kësaj, OShC-të mund të pranojnë donacione nga individë, korporata dhe burime tjera, por në praktikë donacionet individuale dhe korporative nuk janë të shprehura. OShC-të nuk janë të liruara nga TVSH-ja. Sidoqoftë, fondet që vijnë nga BE-ja apo shumica e donatorëve bilateral janë të liruara nga TVSH-ja, pavarësisht se cili operator ekonomik operon me këto fonde. Si rezultat, OShC-të të cilat përfitojnë nga këto fonde gjithashtu i nënshtrohen këtij lirimi, vetëm për atë pjesë të fondeve. Mirëpo, procedura e lirimimit nuk është e njëjtë për të gjithë donatorët dhe lirimi në praktikë shkakton vështirësi për OShC-të në shumë raste.

Për të përfunduar, legjislacioni bazë për themelimin dhe funksionimin e OShC-ve është në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, mirëpo zbatimi i duhur i tij pengohet nga kapacitetet e kufizuara të institucioneve publike dhe mungesa e harmonizimit me ligje/mekanizma tjerë relevant për veprimtarinë e OShC-ve.

#### Rekomandimet kryesore për nën-fushën 1.1 janë:

- Hartimi i kornizës ligjore për kompanitë jofitimprurëse dhe fondet investive/të dhurimeve duhet të iniciohet dhe themelimi e veprimtaria e tyre duhet të rregullohen në mënyrë të qartë
- Kapacitetet e Departamentit për Regjistrimit të OJQ-ve duhet ngritur në mënyrë që të interpretohet dhe zbatohet si duhet Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ
- Korniza ligjore për raportimin financiar të OShC-ve, duke përfshirë legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave, duhet të përfshijë një sistem i cili merr parasysh natyrën specifike të OShC-ve
- Administrata Tatimore e Kosovës duhet t'i ngritë kapacitetet e veta për ta kuptuar dhe adresuar si duhet natyrën specifike të punës së OShC-ve
- Lirimi nga TVSH-ja duhet të behët në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë donatorët e liruar, me qëllim të lehtësimit të ndërmarrjes së procedurave të tilla nga OShC-të

#### Nënfusha 1.2.: Liritë e tjera

Përfaqësuesit e OShC-ve kosovare, individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë liri të tubimit paqësor. Duke u bazuar në nenin 43 të Kushtetutës, Ligji 03/L-118 për tubimet publike të gjithë qytetarëve të Kosovës u garanton të

Në dhjetor të vitit 2012, një tubim i planifikuar i një OShC-je me qëllim të promovimit të drejtave të LGBT nuk është lejuar, derisa një punëtor i asaj OShC-je është rrahur kur një grup prej 30 protestuesve ka hyrë dhe ka dëmtuar pronën në ndërtesën ku ajo OShC kishte planifikuar ta mbajë ceremoninë e fillimit të punës. Një person është arrestuar në lidhje me incidentin, mirëpo policia e ka liruar atë më vonë atë natë.

drejtën të organizojnë dhe marrin pjesë në tubime publike, mirëpo nuk ka dispozita mbi këtë të drejtë për ata të cilët nuk janë qytetarë të Kosovës. Korniza ligjore kërkon njoftim paraprak para tubimit publik, përveç në ato vende ku nuk kërkohen masa shtesë të sigurisë. Në rast se autoritetet nuk japin përgjigje në

<sup>5</sup> Indeksi i shoqërisë civile për Kosovë 2013, KCSF 2014

kohën e duhur (48 orë para tubimit publik)<sup>6</sup>, tubimi publik mund të mbahet pa ndonjë kufizim. Për çfarëdo kufizimi të vërejtur pas njoftimit për tubim publik, organizatorët mund të ankohen në gjykatë përmes procedurës së shpejtë. Kundërtubimet nuk janë të ndaluara specifikisht edhe pse dispozitat lënë të kuptohet se nëse një protestë tjetër është paralajmëruar në lokacionin e njëjtë apo diku afër, kjo mund të shërbejë si arsye për refuzimin e lejes për organizimin e protestës/tubimit publik. Në praktikë, OShC-të nuk kanë paraqitur ndonjë kufizim të së drejtës së tyre të tubimit dhe tubime të shumta ndodhin rregullisht. Mirëpo, një rast i sulmit ndaj një aktiviteti të OShC-ve për të drejtat e LGBT-ve tregon që kur adresohen çështje tabu, kjo e drejtë ende mund cënohet. Për më tepër, është një perceptim i aktivistëve të shoqërive civile se shërbyesit civil në të vërtetë janë të kufizuar në mënyrë indirekte për t'iu bashkuar protestave të organizuara nga OShC-të, sidomos atyre që janë për çështje politike. Tubimet, e sidomos protestat paqësore, zakonisht organizohen nëpër sheshe publike apo përpara ndonjë institucioni specifik të cilat janë në shënjestër të protestës dhe media ka qasje të plotë nëpër këto tubime. Në protesta të organizuara nga OShC-të gjatë periudhës së raportimit, nuk ka raporte për ndonjë përdorim të forcës nga ana e policisë<sup>7</sup>.

Në Kosovë, përfaqësuesit e OShC-ve, individualisht apo nëpërmjet organizatave të tyre gëzojnë të drejtën e shprehjes së lirë për çështje të ndryshme të interesit të tyre. Duke u bazuar në nenin 40 të Kushtetutës, liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë, dhe mund të kufizohet vetëm nëse kjo është e nevojshme për parandalimin e dhunës apo urrejtjes racore, etnike apo fetare. Në përgjithësi, përfaqësuesit e OShC-

Kodi penal, fillimisht i miratuar në prill të vitit 2012, do t'i mbante gazetarët përgjegjës për shpifje apo vepra të tjera "të kryera përmes publikimit të informatave" në çfarëdo mediumi dhe për refuzimin e zbulimit të burimeve të tyre. Në vazhdë të protestave të gjera nga media dhe shoqëria civile, dorëheqja e Ministrit të Drejtësisë në shenjë proteste ndaj këtij akti dhe mospranimi i kodit nga Presidenti i Kosovës, Kuvendi i Kosovës i fshiu nenet e kontestuara nga Kodi Penal në tetor të vitit 2012.

ve, duke përfshirë ata nga të organizatat për të drejtat e njeriut dhe OShC-të mbikëqyrëse, në përgjithësi gëzojnë të drejtën e shprehjes së lirë. Mirëpo, ka raporte për raste të rralla ku përfaqësuesit e OShC-ve janë kërcënuar për fjalimet e tyre kritike

apo adresimin e çështjeve specifike. Sipas Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, ka patur raste të kërcënimit nga zyrtar publik apo përfaqësues të biznesit ndaj gazetarëve të cilët kanë raportuar për korrupsion apo çështje të tjera të paligjshme, derisa reagimi i gjyqësorit apo i policisë nuk ka qenë në përputhshmëri me pritjet e viktimave. Kërcënimet zakonisht kryhen nga individë të cilët jo domosdoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet e institucioneve të tyre. Nuk janë raportuar raste të sanksioneve për fjalime kritike ndaj ndonjë përfaqësuesi të OShC-ve apo gazetari.

OShC-të kanë qasje të lirë në informata dhe janë të lirë të pranojnë dhe japin informata përmes medieve të ndryshme. Mundësia për të komunikuar dhe për t'iu qasur informatave, duke përfshirë edhe internetin dhe Teknologjinë e Komunikimit të Informacionit (ICT), është e garantuar me ligj dhe nuk ka raste të raportuara ku ndonjë kufizim është imponuar ndaj OShC-ve. Shtrirja e internetit në Kosovë është 72.1%,

<sup>6</sup> Ligji Nr. 03/L-118 mbi tubimet publike, neni 6 (3), [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=336&Itemid=28&lang=en](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=336&Itemid=28&lang=en),

<sup>7</sup> Pasi që periudha raportuese përfundon në dhjetor të vitit 2013, rasti i intervenimit policor gjatë protestave të organizuara nga asociacionet e studentëve dhe OShC-të në janar-shkurt të vitit 2014, para Universitetit të Prishtinës, do të mbulohen në raportin e vitit 2014.

derisa në 2011 vetëm 3% të OShC-ve janë deklaruar të mos kenë qasje në internet.<sup>8</sup> Shumica e OShC-ve përdorin mediet sociale për promovimin e punës së tyre, derisa aktivistët e shoqërisë civile janë të lirë të pranojnë dhe japin informata përmes medieve sociale. Duke u bazuar në Ligjin 04/L-109 për komunikimet elektronike, monitorimi i padrejtë i kanaleve të komunikimit është i ndaluar, përveç për raste të monitorimit të bazuara në vendim të gjykatës apo në situata të jashtëzakonshme për arsye të sigurisë kombëtare. Edhe pse OShC-të nuk kanë qenë subjekt i ndonjë monitorimi të publikuar, ka raste të publikimit të materialeve të mbledhura nga monitorimi i kanaleve të komunikimit. Kjo bën që potenciali për keqpërdorim të monitorimit të autorizuar të mbetet një brengë e shoqërisë civile.

Për të përfunduar, liria e tubimit dhe shprehjes janë të garantuara me ligj dhe në përgjithësi OShC-të i ushtrojnë këto të drejta lirisht, edhe pse kohë pas kohe ka raste të kërcënimit ndaj gazetarëve.

#### **Rekomandimet kryesore për nënfushën 1.2 janë:**

- **E drejta e tubimit për jostetas të Kosovës duhet të rregullohet, ku në mënyrë të qartë do t'u garantonte të drejtën e tyre të tubimit**
- **Sistemi gjyqësor dhe policia duhen të reagojnë me më shumë efikasitet në parandalimin apo adresimin e kërcënimeve ndaj përfaqësuesve të OShC-ve dhe gazetarëve**
- **Rastet e raportuara të monitorimit të kanaleve të komunikimit (kryesisht bisedave telefonike) duhen të hetohen dhe rezultatet e hetimeve të publikohen**

---

<sup>8</sup> STIKK, Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë, gusht 2013, p.11, [http://www.stikk-ks.org/uploads/downloads/Depertimi\\_dhe\\_perdorimi\\_i\\_internetit\\_ne\\_Kosove.pdf](http://www.stikk-ks.org/uploads/downloads/Depertimi_dhe_perdorimi_i_internetit_ne_Kosove.pdf); Indeksi Kosovar i shoqërisë civile 2013, KCSF 2014

## Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

### Nënfusha 2.1.: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

Në Kosovë, korniza ligjore mundëson lehtësime tatimore për një numër të burimeve të të ardhurave të OShC-ve, edhe pse efekti i tyre në praktikë është i kufizuar. Grantet dhe donacionet që përkrahin aktivitetet jofitimprurëse të OShC-ve lirohen nga tatimi dhe nuk ka raportime të asnjë tatimi në burime të tilla të të ardhurave. Sa i përket aktivitetit ekonomik, ka paqartësi në kornizën ligjore, sidomos për aktivitetet ekonomike të OJQ-ve të cilat nuk e kanë Statusin për Përfitim Publik. “Çfarëdo organizate joqeveritare e cila kryen çfarëdo aktiviteti komercial apo tjetër i cili nuk është ekskluzivisht i ndërlidhur me qëllimin e tij publik do të ngarkohet me tatim në të ardhura ...”<sup>9</sup>, derisa aktivitetet e ndërlidhura ekonomike të OShC-ve janë të lira nga tatimi deri në “një nivel të arsyeshëm të të ardhurave”<sup>10</sup>. Konkretisht, aktiviteti ekonomik i cilësdo OShC-je të regjistruar duhet të jetë drejtpërdrejtë i ndërlidhur me misionin e tij, ndërsa të gjitha aktivitetet tjera ekonomike i nënshtrohen tatimit në të ardhura. Për më tepër, niveli i arsyeshëm i të ardhurave janë të ardhurat e tilla të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e OShC-ve. Mirëpo, derisa Ligji 03/L- 162 për tatimin në të ardhura të korporatave mund të interpretohet në atë mënyrë që të gjitha organizatat joqeveritare i nënshtrohen lehtësimeve tatimore të lidhura me aktivitetet ekonomike, udhëzimi përkatës administrativ 14/2010 i cili shpjegon zbatimin e tij flet vetëm për organizatat me Status për Përfitim Publik. Kjo mungesë e koherencës shkakton vështirësi në interpretim dhe zbatim, edhe pse ka një numër mjaft të madh të OShC-ve të cilat lirohen nga tatimi për aktivitetet e tyre ekonomike.

Nuk ka dispozita të definuara qartë për përfitimet tatimore për investimet pasive të OShC-ve, derisa investimet pasive nuk janë të shprehura në shoqërinë civile në Kosovë. Ngjashëm, nuk ka dispozita për themelimin dhe veprimtarinë e fondeve investive/të dhurimeve, e as në lidhje me çfarëdo përfitimi tatimor. Përkundër hulumtimeve, nuk është hasur që ndonjë fond i tillë është themeluar ose operon në Kosovë.

Fondacioni IPKO është një fondacion vendor i cili operon në Kosovë që ka për qëllim të krijojë dhe përkrahë zhvillimin e gjeneratës së re të udhëheqësve me vizion digjital për Kosovën. Ky fondacion siguron pjesën kryesore të të ardhurave të tyre përmes të ardhurave të gjeneruara nga kamata nga deponimet e dyta me afat, derisa kamata merret çdo gjashtë muaj.

Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe Ligji për tatimin në të ardhura personale sigurojnë zbritje të tatimeve për donacione nga korporatat apo individët deri në 5% të të ardhurave të tyre të tatueshme, nëse ato kontribute janë për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, të mbrojtjes së mjedisit dhe sportive. Çdo pranues i përshtatshëm i donacioneve përfshinë OJQ-të të cilat kanë Statusin për Përfitim Publik dhe çdo organizatë tjetër jokomerciale që drejtpërsëdrejti kryen veprimtari jofitimprurëse që janë të interesit publik në fushat e përmendura. Ky lehtësim tatimor është dhënë vetëm për një numër të përzgjedhur të aktiviteteve në dobi të publikut, kështu që nuk është në përputhje me Statusin e Përfitimit Publik i cili është i caktuar në Ligjin bazë për OJQ. Në praktikë,

<sup>9</sup> Ligji 03/L- 162 për tatimin në të ardhura të korporatave – neni 33

<sup>10</sup> Udhëzimi administrativ 14/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L0162 për tatim në të ardhura të korporatave – neni 21



shumë pak OShC kanë pranuar donacione individuale apo nga korporatat, mirëpo asnjë prej tyre nuk ka paraqitur zbritjet tatimore si arsyen kryesore për pranimin e atyre donacioneve. Kjo bën të kuptohet që përfitimet tatimore nuk janë motivimi kryesor për donacione. Për më tepër, situata e vështirë ekonomike nuk paraqet një mjedis pozitiv për donacione për shoqërinë civile nga korporatat apo individët. Sipas Indeksit Botëror të Dhënies, Kosova shënon 28% në renditjen e përgjithshme, derisa 30% në dhënie të të hollave<sup>11</sup>. Përgjegjshmëria Sociale e Korporatave (CSR) nuk është një koncept i përhapur shumë nëpër kompanitë private në Kosovë dhe rastet e rralla të CSR kryesisht iniciohen në baza individuale, pa ndonjë politikë shtetërore mbrapa. Në përgjithësi, CSR nuk promovohet as nga shteti, as nga sektori i biznesit e as nga OShC-të.

Për të përfunduar, disa lehtësime tatimore për donatorët privat janë pjesë e kornizës ligjore, por ato nuk janë motivimi kryesor për donacionet private. Statusi për Përfitim Publik ekziston, por nuk prodhon ndonjë efekt në praktikë. Elementet themelore të tij ekzistojnë në Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, mirëpo nuk ka mekanizma zbatues dhe harmonizim me ligjet për tatime dhe ligjet tjera, duke rezultuar kështu në përfitime shumë të kufizuara për bartësit e këtij statusi.

#### **Rekomandimet kryesore për nënfushën 2.1 janë:**

- **Sistemi për zbritje të tatimeve për donacione individuale dhe të korporatave duhet të reformohet sa i përket shkallës dhe fushëveprimit të zbritjeve dhe mekanizmave zbatues të tij**
- **Ligjet për tatime duhen të harmonizohen në tërësi, sidomos me kapitullin për Statusin për Përfitim Publik të Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ**
- **Përgjegjshmëria Sociale e Korporatave do të duhej të ishte pjesë e politikave shtetërore dhe promovimi i saj do të duhej të bëhej nga autoritetet shtetërore, në bashkëpunim me OShC-të**

#### **Nënfusha 2.2.: Përkrahja shtetërore**

Në Kosovë, nuk ka financim publik për zhvillimin institucional të OShC-ve dhe bashkëfinansim të granteve të BE-së apo granteve tjera, derisa përkrahja për projekte është prezente në shumë raste, sidomos në nivelin lokal. Përkrahja shtetërore për OShC-të nuk rregullohet nga asnjë ligj i veçantë apo politikë shtetërore, e ngjashëm nuk ekziston asnjë mekanizëm kombëtar apo lokal për shpërndarjen e fondeve publike tek OShC-të. Në praktikë, pjesa e fondeve publike për shoqërinë civile është rritur nga 8 % në vitin 2010 në 20% të burimeve të përgjithshme të shoqërisë civile në vitin 2013. Këto fonde u shpërndahen OShC-ve nga institucione të veçata të nivelit qendror dhe lokal, pa ndonjë bashkëpunim apo koordinim. Këto fonde nuk janë të planifikuara përbrenda buxhetit shtetëror, ndërsa në buxhetin e vitit 2014 janë identifikuar vetëm katër raste të planifikimit specifik për përkrahje të projekteve të OShC-ve në nivelin qendror/lokal. Sipas buxhetit të vitit 2014, OJQ-të në komunën e Rahovecit do të përkrahen me 8,000 EUR për çështje sociale dhe 15,000 EUR për projekte të zhvillimit rural; në Istog një linjë buxhetore prej 15,000 është dedikuar për pjesëmarrje në projekte kapitale të OJQ-ve, komunitetit dhe donatorëve, derisa projektet lokale të OJQ-ve në Kamenicë do të përkrahen me 25,000 EUR.<sup>12</sup>

Ligji 04/L- 080 për lojërat e fatit siguron mundësinë e drejtimit të një pjese të fondeve nga Lotaria e Kosovës te kategoritë e ndryshme sociale, çështje të të drejtave të njeriut, kulturë dhe sport. Detajet e


<sup>11</sup> Indeksi i dhënies botërore 2013, Një vështrim global i prirjeve të dhënies dhjetor 2013, p.29

<sup>12</sup> Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2014; Financimi i investimeve kapitale 2013-2015, <http://mf.rks.gov.net/en-us/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqendrore.aspx>,

transferimeve të tilla do të duhej të përcaktohen përmes një udhëzimi administrativ, mirëpo një udhëzim i tillë nuk është hartuar ende dhe nuk ka raporte se fonde të tilla janë mbledhur apo shpërndarë. Zyrtarët e intervistuar nga Ministria e Financave nuk ishin në gjendje të na siguronin të dhëna për shumën e fondeve të shpërndara të OShC-të. Përveç kësaj, si përgjigje në kërkesën zyrtare për informata për këtë çështje, Ministria e Financave është përgjigjur se Ligji për buxhetin nuk ka shpërndarje të drejtpërdrejta apo linjë të veçantë buxhetore për organizatat joqeveritare. Kjo konfirmon se financimi është i paparashikueshëm dhe se është e pamundshme të identifikohet shuma e fondeve publike të zotuar apo të ndara për OShC. Pasi buxheti pjesëmarrës nuk është i zakonshëm në Kosovë, OShC-të nuk janë pjesë e ciklit të financimit publik as edhe për fondet publike për shoqërinë civile.

Nuk ka procedura specifike për shpërndarjen e fondeve publike të OShC-të, duke përfshirë mungesën e kriterëve standarde të përzgjedhjes të cilat do të siguronin se financimi publik është shpërndarë në mënyrë të përcaktuar. Për shkak të mungesës së planifikimit specifik të buxhetit dhe të informatave për përzgjedhjen, është shumë vështirë të mblidhen të dhënat e duhura në lidhje me shumën, llojin e projektit dhe organizatat të cilat përfitojnë nga fondet publike. Ka shumë pak informata në dispozicion të publikut për kërkesat e aplikimit dhe shumica e vendimeve për tenderët nuk janë transparente. Të vetmet procedura specifike për OShC-të për adresimin e konfliktit të interesit në lidhje me financimin shtetëror janë të lidhura me OShC-të që kanë zyrtar publik si anëtarë të bordit, edhe pse nuk ka informata në dispozicion në lidhje me drejtësinë e vendimeve apo konfliktin e interesit.

Në Kosovë nuk ka sistem të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimit publik të OShC-ve. Nuk ka procedura të vendosura për sigurimin e llogaridhënies dhe vlerësimi i fondeve publike rregullohet vetëm përmes dispozitave të përgjithshme të Ligjit për prokurimin publik dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të cilët nuk janë të lidhur me punën specifike të OShC-ve. Nuk raportohen shumë raste të vizitave monitoruese nga autoritetet kontraktuese të fondeve publike, dhe atëherë kur ndodhin, nuk ka ndonjë procedurë standarde për veprimet pasuese. Pasi që nuk ekzistojnë dispozitat ligjore, sanksionet për keqpërdorim të fondeve publike nga OShC-të janë identike me ato të subjekteve tjera ligjore, kështu që mund të përfundohet se nuk ka ndonjë proporcionalitet të sanksioneve në raport me madhësinë dhe llojin e OShC-së. Gjithashtu, nuk ka asnjë informatë për ndonjë vlerësim të financimit publik për OShC-të, pasi që ky financim bëhet në mënyrë të pa standardizuar dhe ad-hoc.



Ligji 03/L-226 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës lejon komunat ta ndajnë pronën e paluajtshme për OShC-të, derisa lloji tjetër i përkrahjes jofinanciare i cili është më i zakonshëm është përdorimi pa pagesë i objekteve publike për aktivitete specifike të OShC-ve. 7.14% të OShC-ve kanë raportuar t'u jetë dhënë pronësia apo e drejta e përdorimit afatgjatë të pronave/zyrave komunale, derisa 24.49% të OShC-ve kanë

raportuar përdorim pa pagesë të objekteve publike për aktivitetet e tyre specifike. Mirëpo ligji përshkruan vetëm kriteret e përgjithshme dhe nuk ka proces të përshkruar qartë të përkrahjes së tillë jofinanciare për OShC-të. Edhe pse nuk ka raporte të trajtimit të pabarabartë të OShC-ve në krahasim me sektorët e tjerë, përkrahja jofinanciare kryesisht u është dhënë OShC-ve të cilat përfaqësojnë grupet e marginalizuara dhe organizatat rinore. Në përgjithësi, OShC-të që janë kritike ndaj autoriteteve publike nuk përfitojnë nga ndonjë përkrahje afatgjatë dhe ka vetëm disa raste ku OShC të tilla kanë përfituar nga përkrahja jofinanciare afatshkurtër apo ad-hoc, kryesisht në përdorimin e objekteve komunale për disa prej aktiviteteve të tyre.<sup>13</sup>

Për të përfunduar, qasja e institucioneve publike nuk kontribuon drejt qëndrueshmërisë financiare të OShC-ve. Edhe pse pjesa e financimit publik për OShC-të është në rritje, nuk ka kriteret, standarde e as procedura për programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tyre.

#### **Rekomandimet kryesore për nën-fushën 2.2 janë:**

- **Duhet iniciuar një sistem gjithëpërfshirës për financimin publik, të bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe kriteret, standardet e procedurat e dizajnuara duhet të sigurojnë zbatimin transparent dhe me llogaridhënie të fondeve publike për OShC-të. Pavarësisht sistemit gjithëpërfshirës, të gjitha informatat për fondet publike të shpërndara OShC-ve duhet të bëhen transparente menjëherë.**
- **OShC-të duhet të jenë pjesë e hartimit dhe zbatimit të sistemit gjithëpërfshirës për financimin publik, në përputhje me standardet e Matricës monitoruese.**

#### **Nënfusha 2.3.: Burimet njerëzore**

Kur OShC-të punësojnë punëtorë, nuk ka kërkesa apo regjistrime shtesë në krahasim me kompanitë komerciale dhe OShC-të trajtohen barabartë me punëdhënësit tjerë sipas ligjit. Mirëpo, OShC-të nuk trajtohen në kuadër të programeve të punësimit të nxitura nga shteti, dhe në përgjithësi, sektori i shoqërisë civile nuk trajtohet si

Sipas Ligjit të punës, gratë e punësuar në Kosovë kanë të drejtë në 12 muaj pushim të lehonisë, derisa pagesa gjatë kësaj periudhë ndahet në mes të punëdhënësit dhe qeverisë. Natyra specifike e financimit të OShC-ve bën që organizatat e shoqërisë civile të mos jenë në gjendje të garantojnë të gjitha të drejtat për gratë e punësuar, të cilat mund të lindin fëmijë gjatë periudhës së punësimit me organizatën. Duke pasur qëllim të adresojë këtë çështje, gjatë vitit 2013, shoqëria civile ka kërkuar të trajtohet si sektor i veçantë me nevojat e saj specifike për këtë çështje. Diskutimet fillestare në Kuvend të Kosovës kanë përfshirë OShC-të e interesuara për këtë çështje.

një prej sektorëve i cili kontribuon në punësim. Derisa ka programe të caktuara për gjenerimin e punësimit në sektorin publik dhe privat, OShC-të nuk janë pjesë e kurrfarë përkrahje apo nxitje. Nuk ka statistika për numrin e punëtorëve në sektorin jofitimprurës, derisa të gjitha informatat relevante për shoqërinë civile mbledhen dhe publikohen nga vetë shoqëria civile.

<sup>13</sup> Indeksi i Shoqërisë Civile të Kosovës 2013, KCSF 2014

Në përgjithësi, Kosova nuk ka politika e as ligje favorizuese për vullnetarizëm. Ligji 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë stimulon vullnetarizmin për rininë. Kategoritë tjera nuk janë adresuar nga asnjë ligj, dhe ka raporte se mungesa e njohjes ligjore të vullnetarizmit është një nga arsytet e nivelit të ulët të

Në vitin 2013, vetëm 3.1% të qytetarëve janë deklaruar që kanë bërë punë vullnetare për ndonjë organizatë apo iniciativë të shoqërisë civile, në krahasim me 4.5% në vitin 2011, që tregon një rënie të nivelit të punës vullnetare në Kosovë. Ngjashëm me këtë, 32.67% të OShC-ve janë të mendimit se puna vullnetare në shoqërinë civile është në rënie, në krahasim me 19.8% të cilët e kanë mendimin e kundërt. Mos njohja e punës vullnetare me ligj mbetet një prej arsyeve kryesore për këto prire negative.

punës vullnetare në Kosovë. Nuk ka nxitje shtetërore e as programe për vullnetarizëm të rinjve dhe dispozitat e Ligjit për të rinjtë për vullnetarizëm rrallë zbatohen. Regjistrimi i vullnetarëve të ri është i obligueshëm, ashtu sikurse edhe obligimet për marrëdhënie

kontraktuale dhe mbrojtjen për vullnetarizmin e organizuar rinor. Mirëpo, procedurat administrative për organizatat nikoqire të vullnetarëve rinor janë të komplikuar dhe të rënda për OShC-të, kështu që vullnetarizmi ndodh në forma të tjera, kryesisht pa kurrfarë procedure formale.

OShC-të kosovare përfshijnë një gamë të gjerë të aktiviteteve edukative, kryesisht trajnime afatshkurta në fushën e tyre të punës. Mirëpo edukimi joformal nuk është koncept i cili promovohet përmes politikave dhe ligjeve, me përjashtim të rinisë. Derisa Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit i lejohet të themelojë sisteme të akreditimit dhe njohjes së edukimit joformal, vetëm disa OShC që bëjnë trajnime profesionale janë të akredituara përmes kësaj kornize. Një udhëzim specifik administrativ siguron disa procedura për njohjen e edukimit joformal për rininë. Pavarësisht kësaj, kriteret ekzistuese janë të rënda dhe burokratike dhe mundësia e njohjes së edukimit joformal nuk përdoret. Programi mësimor i sistemit të edukimit formal ka pak tema të lidhura me shoqërinë civile – kryesisht në nivelin fillestar të arsimimit përmes lëndës Edukata Qytetare. Disa universitete private u japin disa mundësi studentëve të vet të punojnë me OShC-të, derisa universitetet publike vazhdojnë të mbesin prapa.

Për të përfunduar, OShC-të nuk përfshihen në politikat të cilat promovojnë punësimin dhe shteti nuk nxit punësimin apo punën vullnetare me OShC.

#### **Rekomandimet kryesore për nënfushën 2.3 janë:**

- **Shteti, gjatë dizajnit të politikave të punësimit, duhet ta njohë shoqërinë civile si një prej sektorëve të cilët gjenerojnë punësim, dhe si rrjedhojë ta përfshijë në programet e punësimit të nxitura nga shteti**
- **Duhet të iniciohet një sistem gjithëpërfshirës për punën vullnetare, i bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, me përfshirje të fushave tjera përtej vullnetarizmit rinor**
- **Lëndët e ndërlidhura me shoqërinë civile duhen të përfshihen në programin mësimor zyrtar të sistemit të arsimit në bashkëpunim me OShC-të, dhe shkollat publike e private dhe universitetet duhen të krijojnë më shumë mundësi për studentët e tyre të punojnë me OShC**
- **Enti Statistikor i Kosovës, Ministria e Punës dhe Administrata Tatimore duhen t'i përfshijnë OShC-të si kategori e statistikave në statistikat e tyre të punësimit, në pajtim me instrumentet e KB/ILO-së**

### **Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri-shoqëri civile**

#### **Nënfusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim**

Pas një Memorandumi të Mirëkuptimit në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile në vitin 2007 dhe një procesi të gjatë të hartimit të dokumentit, Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është miratuar në korrik të vitit 2013. Kjo Strategji përfshin objektivat dhe masat strategjike, si dhe një plan specifik të veprimit me definim të përgjegjësive. Edhe pse plani i veprimit përfshin kostot e parashikuara për secilin aktivitet të planifikuar, deri më tani nuk ka buxhet të ndarë për zbatimin e tij. Si Strategjia ashtu edhe plani i veprimit janë zhvilluar dhe hartuar së bashku, ku shoqëria civile ka siguruar shumicën e ekspertizës për këtë proces. Prosesi i hartimit ka përfshirë shumë OShC nga fusha të ndryshme të interesit. Zbatimi i kësaj Strategjie ende nuk ka filluar, por mekanizmat zbatues janë në proces të dizajnit. Si rezultat, ende është herët të konstatohet ndonjë përmirësim që rrjedh nga kjo strategji. Është planifikuar që kjo strategji do të monitorohet vazhdimisht nga të dyja anët, si dhe do të bëhen vlerësime dhe rishikime periodike. Deri më tani, duke përfshirë procesin e hartimit të strategjisë, shumica e të dhënave janë mbledhur dhe ofruar nga vet OShC-të. Kohëve të fundit, Kuvendi i Kosovës dhe një numër i OShC-ve kanë iniciuar hartimin e një deklaratë të Kuvendit e cila do ta njohë rolin e sektorit dhe do të planifikojë një numër të masave për përmirësimin e bashkëpunimit dhe përkrahjes së shoqërisë civile.

Rëndësia e zhvillimit dhe bashkëpunimit me sektorin ende nuk është njohur tërësisht nga shteti dhe operimi i institucioneve specifike të ndërlidhura me zhvillimin e shoqërisë civile ende është në faza shumë të hershme. Konkretisht, Zyra për Qeverisjen e Mirë e Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM) është njësi qendrore me mandat të lehtësimit të bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile. Pas miratimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, ZQM/ZKM gjithashtu i është dhënë detyra që të shërbejë si sekretariat për Këshillin e përbashkët, këshill ky i cili do të themelohet si trup konsultativ për zbatimin e strategjisë. Derisa kjo detyrë është vetëm një prej detyrave të shumta të kësaj zyre, ZQM/ZPM nuk ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore ta lehtësojë dialogun Qeveri-shoqëri civile, njëjtë sikur edhe për mandatin që të shërbejë si sekretariat i Këshillit të përbashkët. Edhe pse emri i saj tregon një mandat të bashkëpunimit me shoqërinë civile, Departamenti i Regjistrimit dhe Ndërlidhjes me OJQ përbrenda Ministrisë së Administratë Publike merret vetëm me regjistrimin e OJQ-ve dhe Statusin për Përfitim Publik, ndërsa ndërlidhja e bashkëpunimi pothuajse nuk bëjnë pjesë në punën e këtij departamenti. Në nivel të Kuvendit të Kosovës, pas iniciativës së një organizate ndërkombëtare e cila e përkrah punën e Kuvendit, një zyrtar për ndërlidhje me shoqërinë civile është emëruar kohëve të fundit, me qëllim të shërbejë si pikë kontakti për OShC-të të cilat janë të interesuara të përfshihen në punën e Kuvendit dhe komisioneve të tij. Për shkak që është themeluar vetëm kohëve të fundit, kjo pozitë ende nuk ka prodhuar ndonjë përmirësim në marrëdhëniet e shoqërisë civile dhe Kuvendit. Sa i përket përfshirjes së OShC-ve në vendimet e marra nga këto institucione, Strategjia qeveritare parasheh konsultim të vazhdueshëm me OShC-të në të gjitha gjërat e lidhura me bashkëpunimin në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile, derisa dizajni i modaliteteve zbatuese për strategjinë është duke u kryer në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Për të përfunduar, Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile e miratuar kohëve të fundit jep një kornizë gjithëpërfshirëse për përmirësimin e ambientit për zhvillimin e shoqërisë civile, mirëpo skema e tashme institucionale dhe burimet njerëzore e financiare nuk garantojnë zbatimin e duhur të saj.

### Rekomandimet kryesore për nënfushën 3.1 janë:

- Duhet të ketë fonde specifike të ndara për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe edukim të vazhdueshëm dhe ngritje të kapaciteteve për shërbyesit civil për këtë Strategji dhe rolin e tyre në zbatimin e saj
- Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit duhet të themelojë një njësi të veçantë për bashkëpunim me shoqërinë civile, me mandat të lehtësimit të bashkëpunimit Qeveri-OShC, si dhe të investojë në kapacitetet e saj njerëzore dhe financiare
- Enti i Statistikave të Kosovës duhet të bashkëpunojë me OShC-të që merren me zhvillimin e shoqërisë civile dhe t'i publikojë të dhënat relevante për sektorin e shoqërisë civile

### Nënfusha 3.2.: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes

Korniza ligjore për përfshirjen e OShC-ve në proceset e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave jep mundësi të shumta për kontributin e OShC-ve në të dyja nivelet e qeverisjes, mirëpo mangësitë në


zbatimin e duhur dhe mungesa e standardeve konkrete nuk u mundëson OShC-ve të japin kontributin e tyre në kohën e duhur. Konkretisht Rregullorja e punës së qeverisë kërkon konsultime publike për të gjitha draft ligjet/politikat, ofrim të informatave të mjaftueshme dhe

Në nivelin qeveritar, ministratë gjithnjë e më shumë janë duke i ftuar OShC-të që të japin komente me shkrim, por zakonisht kjo nuk bëhet në fazat e hershme dhe nuk ka përcjellje të mëtejshme që bëhet. Në shumicën e rasteve OShC-të nuk marrin informata adekuate për përmbajtjen e draft dokumentit, dhe koha e zakonshme për t'iu përgjigjur ftesës ministrore është 15 dite pune. Ka numër shumë të vogël të rasteve ku përgjigjet me shkrim për rezultatet e konsultimeve janë dhënë apo venë në dispozicion të publikut.

të përshtatshme nga ana e autoritetit propozues, si dhe informata kthyesë për rezultatet e konsultimit. Vetëm 29.29% të OShC-ve janë deklaruar se janë ftuar rregullisht në konsultime për ligje/politika relevante për punën e tyre. Mirëpo pasi që nuk ka standarde për zbatimin e duhur të këtyre dispozitave, këto kërkesa zbatohen vetëm pjesërisht. Rregullorja e punës së Kuvendit përmban dispozita jo-obligative

për të ftuar OShC-të dhe të organizuar dëgjime publike, ndërsa Komisionet e Kuvendit organizojnë dëgjime publike vetëm për një numër të caktuar të ligjeve. Ngjashëm, Ligji për vetëqeverisje lokale ofron instrumente të ndryshme të pjesëmarrjes së publikut në nivelin lokal, duke përfshirë konsultimet publike, komisionet sektoriale konsultative, petitionet, takimet publike me Kryetarin e komunës, etj. Mirëpo shumica e komunave nuk e përfshijnë shoqërinë civile rregullisht dhe shumë instrumente ligjore ekzistuese nuk janë të funksionalizuara si duhet. Sa i përket kapaciteteve të shërbyesve civil për ta


**Ftesat për konsultim publik nga autoritetet publike**





përfshirë shoqërinë civile, nuk ka programe edukimi/trajnimi për shërbyesit civil për këtë çështje. Një numër i kufizuar i trajnimeve janë organizuar kryesisht nga shoqëria civile dhe ka shumë pak shërbyes civil që janë përgjegjës për hartimin e politikave publike e të cilët kanë kryer ndonjë program të edukimit/trajnim për përfshirjen e OShC-ve. Pasi që kjo komponentë është një prej masave specifike të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, mund të pritët përmirësim në të ardhmen e afërt. Në fund, me përjashtim të Kuvendit të Kosovës, institucionet tjera nuk kanë njësi/zyrtar të veçantë të cilët koordinojnë dhe monitorojnë procesin e konsultimit publik. Në Ministri, procesi i konsultimit publik zakonisht udhëhiqet nga departamentet e tyre ligjore, derisa në komuna ka praktika të ndryshme të punës.

Korniza ligjore nuk i obligon shprehimisht institucionet publike që në mënyrë proaktive t'i publikojnë të gjitha ligjet dhe politikat, derisa publikimi i ligjeve/politikave të cilat janë duke u diskutuar është e lidhur me procesin e konsultimit publik. Si rezultat, nuk ka qasje të lehtë në shumicën e draft ligjeve dhe politikave në kohën e duhur. Konkretisht, qasja në informata publike është e drejtë kushtetuese, e garantuar përmes nenit 41 të Kushtetutës. Ligji 03/L-215 për qasje në dokumente publike i obligon të gjithë institucionet që në formë proaktive të publikojnë të gjitha dokumentet e miratuara, por nuk kërkon në mënyrë të qartë publikimin e drafteve të dokumenteve në procedurë. Këto dokumente janë publike vetëm bazuar në kërkesat nga palët e jashtme. Mirëpo, dokumentet që rregullojnë punën e nivelit qeveritar dhe lokal kërkojnë që institucionet të konsultojnë publikun gjatë hartimit të ligjeve/politikave/rregulloreve, dhe ky proces gjithashtu nënkupton publikimin e drafteve të dokumenteve. Kur flasim për kërkesa për qasje në dokumente publike, ka procedura dhe mekanizma ligjor të definuar qartë për qasje në informata/dokumente publike. Në praktikë, numri i kërkesave zyrtare



nga shoqëria civile nuk është i madh dhe institucionet publike nuk u përgjigjen atyre rregullisht përbrenda afatit kohor prej 7 ditë pune. 58.2% të OShC-ve konsiderojnë se kanë qasje të kufizuar apo nuk kanë qasje fare në informata relevante për

punën e tyre, derisa 37.11% të OShC-ve kurrë nuk kanë dorëzuar kërkesë për qasje në informata/dokumente.<sup>14</sup> Sipas raportit të vitit të Zyrës së Kryeministrit, shumica e kërkesave vijnë nga gazetarët, derisa shoqëria civile ka një pjesë më të madhe të kërkesave për qasje në dokumente publike në nivelin lokal (Komuna - 44%, Presidenca/Kuvendi/Gjykata Kushtetuese - 34%, Qeveria qendrore - 22% dhe Agjencitë e pavarura - 9%). Pjesa më e madhe e refuzimeve bëhet përmes heshtjes administrative, derisa rastet e shpjegimeve me shkrim për arsyet e refuzimit janë shumë të rralla. Ligji për qasje në dokumente publike përmban sanksione monetare të përshkruara qartë për shërbyes civil dhe institucione të cilat i shkelin kërkesat ligjore për qasje në dokumente zyrtare, mirëpo nuk ka raportime se rastet e shkeljes së ligjit janë sanksionuar.

<sup>14</sup> Indeksi Kosovar i shoqërisë civile 2013, KCSF 2014

Përfaqësuesit e OShC-ve marrin pjesë nëpër trupa ndërsektorial mirëpo përzgjedhja e tyre rrallëherë bëhet duke u bazuar në kritere dhe procese të definuara qartë. Legjislacioni lejon, mirëpo nuk i obligon institucionet publike t'i ftojnë përfaqësuesit e OShC-ve nëpër trupa të vendimmarrjes apo këshilluese të krijuara nga ana e institucioneve publike. Si përjashtim, komisionet sektoriale konsultative në nivelin komunal duhen të themelohen dhe të përbëhen nga qytetarët dhe shoqëria civile, mirëpo vetëm disa komuna e kanë përmbytur këtë obligim. Nuk ka udhëzues apo mekanizma standard të përzgjedhjes që do të siguronin përfaqësimin e përshtatshëm nga shoqëria civile, derisa kjo është një prej aktiviteteve specifike të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile. Ka shumë trupa vendimmarrës dhe këshillues të cilët përfshijnë përfaqësues të OShC-ve nëpër nivele të ndryshme të qeverisjes. Disa trupa kombëtar (siç është Këshilli Kombëtar për Integrim European) kanë përzgjedhur përfaqësues të OShC-ve përmes procedurës së hapur të nominimit, mirëpo kjo praktikë nuk është e zakonshme. Në përgjithësi, përfaqësuesit e OShC-ve në këta trupa janë të lirë të prezantojnë dhe mbrojnë pozitat e tyre pa u sanksionuar. Ngjashëm, shumica e OShC-ve që marrin pjesë në trupa vendimmarrës dhe këshillues përdorin mënyra tjera të avokimit, të cilat nuk janë domosdoshmërisht në përputhje me pozitën e trupit përkatës.

Për të përfunduar, avancimet e kohëve të fundit në kornizën ligjore të nivelit qendror kanë përmirësuar përfshirjen e OShC-ve në hartimin e politikave, mirëpo ende mungon zbatimi i duhur dhe standardet e definuara qartë të konsultimit.

#### **Rekomandimet kryesore për nënfushën 3.2 janë:**

- **Legjislacioni duhet të plotësohet me Standardet minimale për konsultime publike në nivelin qeveritar, i cili duhet të mbulojë tërë ciklin e vendimmarrjes, duke filluar nga caktimi i agjendës e deri te riformulimi**
- **Mekanizmat e përgjithshëm për përzgjedhje duhen të dizajnohen nga Qeveria, për t'u mundësuar të gjitha institucioneve publike t'i aplikojnë ato me përshtatje të veçanta**
- **Kuvendi i Kosovës duhet të hartojë kërkesa obligative për përfshirjen e OShC-ve në punën e komisioneve të Kuvendit, derisa këto komisione duhet të organizojnë dëgjime publike për të gjitha draft ligjet që janë në procedurë**
- **Ligji për qasje në dokumente publike duhet të ndryshohet në atë mënyrë që t'i obligojë institucionet publike t'i publikojnë në mënyrë proaktive draft ligjet/politikat dhe iniciativat e politikave**
- **Institucionet publike duhen të bashkëpunojnë me shoqërinë civile në ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civil për përfshirjen e OShC-ve**

#### **Nënfusha 3.3.: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve**

Në Kosovë, vetëm një numër i kufizuar i OShC-ve janë të përfshira në ofrimin e shërbimeve të ndryshme të cilat paguhen nga fondet shtetërore. Ligji 04/L-042 për prokurimin publik lejon OShC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme, edhe pse ka disa barriera ligjore të fshehta, të cilat në disa raste i ndalojnë OShC-të të jenë të pranueshme për kontrata për ofrimin e shërbimeve. Për shembull, e vetmja certifikatë e regjistrimit e përshtatshme sipas ligjit është "certifikata e vlefshme e regjistrimit e lëshuar nga autoriteti publik përgjegjës për regjistrimin e organizatave të biznesit në Kosovë". Edhe pse kërkesat ligjore janë të njëjta për të gjitha subjektet juridike, duke përfshirë OShC-të, këto dispozita nuk janë në

përputhje me natyrën specifike të punës së OShC-ve. Situatë e ndryshme është në fushën e shërbimeve sociale, të cilat rregullohen përmes Ligjit 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (dhe ndryshimet e tij), i cili formalisht e njeh mundësinë dhe lejon që shërbime sociale të ndryshme të ofrohen nga OShC-të. Ky ligj merr parasysh natyrën specifike të punës së OShC-ve, kështu që nuk ka barriera të cilat janë pjesë e legjislacionit. Në praktikë, ka pak OShC të cilat janë të gjendje të pajisen me kontrata për shërbime, dhe shumica e tyre janë në fushën e shërbimeve sociale dhe fusha ku nuk ekzistojnë ofrues tjerë të shërbimeve. Këto OShC janë të përfshira në disa prej fazave të zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve, edhe pse përfshirja e plotë e tyre në të tërë ciklin nga planifikimi deri te vlerësimi ende mbetet prapa. Për OShC që ofrojnë shërbime sociale, regjistrimi dhe licencimi paraprak është i nevojshëm dhe procedura për marrjen e licencës është e njëjtë me ofruesit e tjerë të shërbimeve. Baza e re ligjore është duke u hartuar, derisa një prej objektivave strategjike të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është ta hap të tërë sistemin e shërbimeve për OShC-të dhe të themelojë një sistem gjithëpërfshirës të parimeve dhe standardeve për ofrimin e shërbimeve nga OShC-të.

Edhe pse nuk ka të dhëna në dispozicion nga institucionet shtetërore, sipas OShC-ve financimi shtetëror për shërbime të ofruara nga OShC-të është i kufizuar dhe financimi nuk është i parashikueshëm apo në dispozicion për periudhë afatgjatë. Ligji i ndryshuar për shërbime sociale dhe familjare obligon institucionet të sigurojnë fonde vjetore për OShC-të që ofrojnë shërbime sociale, por vetëm disa OShC që ofrojnë shërbime sociale marrin fonde nga institucionet publike. Në shumicën e rasteve, ky financim nuk është i mjaftueshëm as për mbulimin e shërbimeve të cilat ato i ofrojnë, lere më për shpenzimet institucionale, të cilat në përgjithësi janë të përjashtuara nga financimi publik. Legjislacioni lejon institucionet të sigurojnë vetëm fonde vjetore, kështu që financimi nuk është i parashikueshëm për periudha më të gjata kohore. Për më tepër, shumë OShC raportojnë vonesa në pagesa, derisa financimi nuk është fleksibil në raport me cilësinë e shërbimeve të dhëna.

Procedurat për kontraktimin e shërbimeve nuk janë të definuara qartë dhe nuk garantojnë përzgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve. Derisa procedurat e përgjithshme të prokurimit nuk marrin parasysh natyrën specifike të punës së OShC-ve dhe kanë barriera të fshehta për OShC-të (p.sh. kërkesat për certifikatën e regjistrimit të biznesit për OShC-të të cilat dëshirojnë të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme), procedura e financimit të shërbimeve sociale dhe kriteret nuk janë të rregulluara me ligj por përmes udhëzimeve administrative vjetore. Në praktikë, në shumicën e rasteve të ofrimit të shërbimeve sociale nga OShC-të, kriteret e përzgjedhjes janë të bazuara në vlerat më të mira për cilësi, ekspertizën teknike dhe vlerësimin financiar të aplikuesve. Baza ligjore përmban dispozita të përgjithshme për adresimin e konfliktit të interesit, mirëpo ka raste kur OShC-të aplikuese i konsiderojnë tenderët për shërbime sociale në shpërputhje me procedurat dhe kriteret ligjore. Ligji siguron të drejtën e ankesës kundër rezultateve të tenderit. Si rezultat, ka disa shërbime sociale për të cilat kontraktohen OShC-të, derisa për lloje të tjera të shërbimeve OShC-të kontraktohen shumë rrallë. Sa i përket kapaciteteve të zyrtarëve të cilët i organizojnë procedurat, OShC-të mendojnë se shumica e tyre kanë kapacitete të mjaftueshme teknike për organizimin e procedurave, mirëpo u mungon të kuptuarit e konceptit të ofrimit të shërbimeve nga OShC-të.

Përkundër ekzistencës së një baze ligjore, nuk ka sistem të qartë të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve të dhëna nga OShC-të. Ka një bazë ligjore për monitorimin e shpenzimeve të OShC-ve të cila ofrojnë shërbime sociale, mirëpo nuk ekzistojnë standarde të cilësisë dhe procedura konkrete të monitorimit. Procesi i hartimit të bazës ligjore për monitorim cilësor është në proces, me

pjesëmarrjen e OShC-ve. Në praktikë, ka vizita në terren dhe inspektime, të cilat zakonisht janë të paralajmëruara. Pjesa më e madhe e monitorimit është e përqendruar në vërtetimin e shpenzimeve dhe aspektet teknike të ofrimit të shërbimeve, pa ndonjë monitorim dhe vlerësim cilësor. Nuk ka vlerësime të rregullta të cilësisë dhe efekteve/ndikimeve të shërbimeve të ofruara.

Për të përfunduar, përveç ofrimit të shërbimeve sociale, pjesa tjetër e ambientit për ofrim të shërbimeve kryesisht është e mbyllur për OShC-të dhe nuk i mundëson OShC-ve të bëhen ofrues të barabartë të shërbimeve.

#### **Rekomandimet kryesore për nënfushën 3.3 janë:**

- **Ligji për prokurimin publik duhet të ndryshohet që të lejojë pranimin e certifikatave të regjistrimit të OJQ-ve, njëjtë si certifikatat e regjistrimit të biznesit,**
- **Baza e re ligjore për licencimin e shërbimeve sociale dhe ofrimin e tyre duhet të jetë në përputhje me parimet e caktuara në Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile**
- **Institucionet shtetërore duhen të vënë në dispozicion fonde të mjaftueshme për OShC-të që ta mbulojnë vlerën e vërtetë të shërbimeve të ofruara dhe shpenzimet institucionale të OShC-ve, derisa legjislacioni duhet të ndryshohet që të lejojë kontrata shumëvjeçare për OShC-të**

# Të gjeturat dhe rekomandimet (forma tabelore)

## Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

### Nën-fusha 1.1.: Liria e asociimit

#### Parimi: Liria e asociimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Të gjithë individët dhe subjektet juridike mund të krijojnë dhe të marrin pjesë lirisht në organizata joformale dhe/ose të regjistruara, offline dhe online.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ekziston një kornizë ligjore sipas të cilës çdo person mund të krijojë shoqata, fondacione dhe lloje të tjera subjektesh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare (p.sh. kompani jo-fitimprurëse) për çfarëdo qëllimi.</li> <li>2) Korniza ligjore lejon si personat juridikë dhe individët të ushtrojnë këtë të drejtë pa diskriminim (moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie etj).</li> <li>3) Regjistrimi nuk është i detyrueshëm, dhe në rastet kur organizatat vendosin të regjistrohen, rregullat e regjistrimit janë të përcaktuara në mënyrë të qartë që të lejojnë një proces regjistrimi dhe ankese të lehtë, jo shumë të gjatë në kohë dhe të pakushtueshëm.</li> <li>4) Ligji lejon për krijimin e rrjeteve midis organizatave në vendet e tyre dhe jashtë vendit, pa njoftim paraprak</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore lejon pa dallim të gjithë individët dhe personat juridikë të themelojnë shoqata, fondacione, parti politike, organizata fetare, oda ekonomike dhe sindikata</li> <li>• Korniza ligjore nuk e rregullon themelimin e kompanive jofitimprurëse</li> <li>• Regjistrimi nuk është i detyrueshëm</li> <li>• Rregullat e regjistrimit janë të përshkruara qartë, nuk kërkohet pagesë dhe përgjigja e autoriteteve duhet të jepet brenda 60 ditëve</li> <li>• Korniza ligjore lejon mundësinë e ankesës , mirëpo nuk ka përshkrim të qartë të rregullave ndërsa autoriteti i njëjtë ka mandatin ta themelojë komisionin për ankese</li> <li>• Korniza ligjore nuk ndalon rrjetëzimin e organizatave brenda dhe jashtë Kosovës, dhe për këtë nuk duhet ndonjë njoftim paraprak</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni i ndryshuar apo i ri duhet të rregullojë shprehimisht themelimin dhe operimin e kompanive jofitimprurëse dhe të fondeve investive/të dhurimeve</li> <li>• Duhet hartuar rregulla dhe procedura të qarta për procedurën e ankesës</li> <li>• Afati për t'iu përgjigjur kërkesave për regjistrim duhet shkurtuar</li> <li>• Ligji duhet të ndryshohet që të lejojë regjistrimin automatik në raste kur nuk merret vendim brenda afatit për t'u përgjigjur</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <p>1) Çdo person fizik apo juridik në praktikë mund të formojë shoqata, fondacione apo forma të tjera subjektsh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare offline apo online.</p> <p>2) Personat fizikë dhe juridikë nuk sanksionohen për mos-regjistrimin e organizatave të tyre.</p> <p>3) Regjistrimi është me të vërtetë i arritshëm brenda afateve të përcaktuara me ligj; autoritetet vendosin mbi rastet në mënyrë jo-subjektive dhe apolitike.</p> <p>4) Individët dhe OShC-të mund të formojnë dhe të marrin pjesë në rrjete dhe koalicione, brenda dhe jashtë vendeve të tyre.</p>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në praktikë, secili individ apo entitet juridik mund të themelojë organizatë jofitimprurëse, përveç kompanive jofitimprurëse</li> <li>Askush nuk sanksionohet për mos-regjistrimin e organizatave të tyre, edhe pse organizatat e paregjistruara ballafaqohen me probleme të ndryshme administrative gjatë funksionimit të tyre</li> <li>Sistemi i regjistrimit në internet është vënë në veprim kohëve të fundit, por regjistrimi përmes internetit nuk është i pranishëm</li> <li>Në shumicën e rasteve, regjistrimi është i qasshëm për të gjithë të interesuarit brenda afatit kohor prej 60 ditësh, edhe pse ka shumë pak raste të raportuara të vendimeve ose kërkesave të paligjshme dhe vonesave</li> <li>Çdokush mund të formojë dhe marrë pjesë nëpër rrjete dhe koalicione, brenda dhe jashtë Kosovës</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kapacitetet e autoritetit për regjistrim duhen të ngriten në mënyrë që t'i interpretojnë dhe zbatojnë si duhet dispozitat ligjore</li> <li>Autoriteti për regjistrim nuk duhet të kërkojë dokumente shtesë, përveç atyre të kërkuara sipas ligjit</li> <li>Sistemi i regjistrimit përmes internetit tashmë i dizajnuar duhet të promovohet dhe të bëhet plotësisht operativ</li> <li>Trupi për ankesa duhet të bëhet operativ dhe të përfshijë përfaqësues të OShC-ve, ndërsa mundësia e ankesës duhet të promovohet më shumë</li> </ul>
--	---	--	---

### Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

#### Nën-fusha 1.1.: Liria e asociimit

#### Parimi: Liria e asociimit është e garantuar dhe ushtrohet lirshëm nga të gjithë

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>OShC-të veprojnë lirishëm, pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen e tyre të brendshme dhe aktivitete.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <p>1) Korniza ligjore ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse.</p> <p>2) Shteti siguron mbrojtje nga ndërhyrje të palëve</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Korniza ligjore ndalon autoritet publike të ndërhyjnë në punën dhe aktivitetet e OJQ-ve</li> <li>Nuk ekzistojnë dispozita specifike ligjore për mbrojtjen shtetërore nga ndërhyrja e palëve të treta në ushtrimin e lirisë së asociimit</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Korniza ligjore për raportimin financiar të OShC-ve duhet të ndryshohet që të marrë parasysh natyrën specifike</li> </ul>



	<p>të treta.</p> <p>3) Raportimi financiar (duke përfshirë rregulloret e pastrimit të parave) dhe rregullat e kontabilitetit merr parasysh natyrën specifike të OShC-ve dhe janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin/qëllimin e aktiviteteve të saj.</p> <p>4) Sanksionet për shkeljen e kërkesave ligjore duhet të bazohen në legjislacionin në fuqi dhe të ndjekin parimin e proporcionalitetit.</p> <p>5) Kufizimet dhe rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe janë të bazuara në kritere objektive të cilat kufizojnë vendimmarrjen arbitrare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetëm organizatat me SPP me të ardhura më të larta se 100,000 EUR duhen të dorëzojnë raport të auditimit të jashtëm</li> <li>• Korniza ligjore për raportim financiar të OShC-ve është e ngjashme me kompanitë private dhe nuk e merr parasysh madhësinë dhe llojin/fushën e aktivitetit të OShC-ve</li> <li>• Rregullat për pastrimin e parave kanë pragje më të ulëta të raportimit për OShC-të në krahasim me subjektet e tjera</li> <li>• Sanksionet për shkeljen e rregullave të pastrimit të parave nuk janë proporcionale me nivelin e shkeljes dhe nuk janë në përputhje me dispozitat e shuarjes së OJQ-ve të Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ</li> <li>• Sanksionet për raportimet tatimore janë të ngjashme me kompanitë private dhe proporcionaliteti i njejtë aplikohet gjithashtu për OShC-të</li> <li>• Rregullat e shuarjes së OJQ-vë janë në përputhje me ligjet ndërkombëtare dhe të bazuara në kritere objektive, përveç dispozitave të Ligjit për pastrim të parave</li> <li>• Rregullat për themelimin dhe procedurat e Komisionit për shpërndarje të aseteve të mbetura të OJQ-ve të shuara nuk ekzistojnë</li> </ul>	<p>të OShC-ve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për pastrimin e parave duhet të ndryshohet që të sigurojë pragje më të larta të transaksioneve nga dhe në OShC, si dhe të përcaktojë kritere e procedura të qarta për zbatim</li> <li>• Sanksionet për shkelje të rregullave për pastrim të parave duhen ndryshuar që të marrin parasysh nivelin e shkeljes dhe dispozitat e shuarjes të Ligjit mbi Lirinë e Asociimit në OJQ</li> <li>• Rregullat për themelimin dhe procedurat e Komisionit për shpërndarje të aseteve të mbetura të OJQ-ve të shuara duhen të hartohen, në bashkëpunim me OShC-të</li> </ul>
	<p><b>Praktika:</b></p> <p>1) Nuk ka raste të ndërhyrjes shtetërore në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse.</p> <p>2) Nuk ka praktika të mbikëqyrjes arbitrare të cilat të imponojnë kërkesa të rënduara raportimi.</p> <p>3) Sanksionet aplikohen në raste të rralla/ekstreme, ato janë proporcionale dhe janë subjekt i një shqyrtimi gjyqësor.</p>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka asnjë rast të raportuar të ndërhyrjes shtetërore në çështje të brendshme të subjekteve jofitimprurëse</li> <li>• Më shumë se gjysma e OShC-ve konsiderojnë se kërkesat e raportimit financiar nuk përputhen me natyrën specifike të OShC-ve</li> <li>• Shumica e OShC-ve raportojnë se nuk kanë pasur vizita nga autoritetet tatimore gjatë tre viteve të fundit</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrata Tatimore e Kosovës duhet t'i ngritë kapacitetet e veta për ta kuptuar dhe adresuar si duhet natyrën specifike të punës së OShC-ve</li> <li>• Autoritetet tatimore duhen të hartojnë udhëzues lehtë të përdorshëm dhe të</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Janë raportuar raste të rralla të “vizitave të papritura” nga autoritetet tatimore</li> <li>• Pak raste janë raportuar ku administrata tatimore ka kërkuar dokumente dhe dëshmi jofinanciare</li> <li>• Sanksionet për OShC-të nuk janë të zakonshme dhe nuk ka dëshmi të sanksioneve joproporcionale</li> </ul>	mbajnë trajnime për OShC-të që t'i ndihmojnë të gjitha OShC-të t'i përmbushin kërkesat e raportimit
--	--	---	---

## Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

### Nën-fusha 1.1.: Liria e asociimit

#### Parimi: Liria e asociimit është e garantuar dhe ushtrohet lirshëm nga të gjithë

STANDARDI 3	INDIKATORËT	TË GJETURAT	RECOMMENDATIONS FOR THE STANDARD
OShC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirshëm burime financiare nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja, për të mbështetur aktivitetet e tyre.	<b>Legjislacioni:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Legjislacioni lejon OShC-të të angazhohen në aktivitete ekonomike.</li> <li>2) OShC-të lejohen të marrin fonde të huaja.</li> <li>3) OShC-të lejohen të marrin fonde nga individët, korporatat dhe burime të tjera.</li> </ol>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore lejon OShC-të të merren me aktivitete ekonomike</li> <li>• Korniza ligjore lejon OShC-të të pranojnë fonde nga jashtë</li> <li>• Korniza ligjore lejon OShC-të të pranojnë fonde nga individët, korporatat dhe nga burime të tjera</li> <li>• Korniza ligjore për lirim nga taksat doganore nuk është e qartë dhe organizatat me SPP nuk trajtohen në mënyrë standarde</li> </ul>	<b>Legislation:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lirimet nga taksat doganore duhet t'u mundësohet të gjitha organizatave me SPP ndërsa procedurat e liritimit duhet të thjeshtohen</li> </ul>
	<b>Praktika:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Legjislacioni për OShC-të që angazhohen në aktivitete ekonomike zbatohet dhe nuk përbën barrë për OShC-të.</li> <li>2) Nuk ka kufizime (p.sh. barrë administrative ose financiare, para-miratime, apo kanalizim të fondeve të tilla nëpërmjet organeve të veçanta) për OShC-të për të marrë fonde të huaja.</li> </ol>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në praktikë, numër i vogël i OShC-ve merren me aktivitete ekonomike. OShC-të nuk janë të njoftuar me obligimet dhe kufizimet për aktivitete ekonomike dhe nuk ka këshillim ligjor në dispozicion</li> <li>• Janë raportuar kufizime në pranimin e financimit nga jashtë</li> </ul>	<b>Practice:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedura për lirim nga TVSH duhet të unifikohet për të gjithë donatorët, me qëllim të zbatimit të procedurave të tilla nga OShC-të</li> </ul>

	<p>3) Marrja e fondeve nga individët, korporatat dhe burime të tjera është e lehtë, efektive dhe pa ndonjë kosto të panevojshme apo barrë administrative.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lirimi nga TVSH është dhënë duke u bazuar nga lloji i donatorit dhe aplikohen procedura të ndryshme. Disa procedura për lirim janë të rënda dhe të vështira të zbatohen</li> <li>• Lirimi i zakonshëm nga tatimi është dhënë kryesisht duke u bazuar në llojin e donatorit dhe shumica e procedurave për lirim janë të rënda dhe të vështirë të zbatueshme</li> <li>• OShC-të janë të lira të marrin financim nga burime të ndryshme private</li> </ul>	
--	---	--	--

### Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

#### Nën-fusha 1.2.: Liritë e tjera

#### Parimi: Liritë e tubimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Përfaqësuesit e OShC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatës së tyre, gëzojnë lirinë e tubimit paqësor.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Korniza ligjore është e bazuar në standardet ndërkombëtare dhe siguron të drejtën e lirisë së organizimit për të gjithë pa asnjë diskriminim.</li> <li>2) Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë tubimet spontane, të njëkohëshme dhe kundër-tubimet.</li> <li>3) Për ushtrimin e të drejtës së tubimit nuk kërkohet autorizim paraprak nga autoritetet, por më e shumta një procedurë e njoftimit paraprak, e cila nuk është e rëndë.</li> <li>4) Çdo kufizim i së drejtës bazuar në ligj dhe lëshuar nga autoriteti rregullator mund të apelohej nga organizatorët.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore u garanton të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës të drejtën të organizojnë dhe marrin pjesë në tubime publike</li> <li>• Korniza ligjore nuk përmban dispozita ligjore në lidhje me të drejtën për tu tubuar për ata të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës</li> <li>• Korniza ligjore në mënyrë indirekte lë të kuptohet se kundër-tubimet nuk janë të lejuara</li> <li>• Korniza ligjore kërkon njoftim paraprak për tubime publike, përveç në ato vende ku nuk kërkohen masa shtesë sigurie (stadiume etj.) dhe/apo objekte të mbyllura. Në raste kur nuk është dhënë përgjigje nga autoritet përbrenda kohës së duhur, tubimi publik mund të mbahet pa asnjë kufizim</li> <li>• Për çfarëdo kufizimi pas njoftimit për tubim publik organizatorët mund të bëjnë ankesë në</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore duhet ndryshuar që të lejojë të drejtën e tubimit edhe për josh tetas të Kosovës, si dhe të lejojë kundër-tubimet</li> </ul>

		gjykatë përmes procedurës së shpejtë	
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Nuk ka raste të shkeljes së lirisë së tubimit, dhe çdo grup njerëzish mund të mbledhet në vendin dhe kohën e dëshiruar, në përputhje me dispozitat ligjore.</li> <li>2) Kufizimet janë të justifikuara me shpjegimin e arsyes për çdo kufizim, i cili i komunikohet menjëherë me shkrim organizatorit për të garantuar mundësinë e ankesës.</li> <li>3) Tubimet e njëkohëshme dhe spontane mund të mbahen dhe shteti lehtëson dhe mbron grupet për të ushtruar të drejtën e tyre kundër njerëzve të cilët synojnë për të parandaluar ose prishur mbledhjen.</li> <li>4) Ka raste të ushtrimit të lirisë së tubimit nga OShC-të (individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre) pa autorizim paraprak, ndërsa në rastet kur nevojitet njoftimi ai dorëzohet në një periudhë të shkurtër kohe dhe nuk kufizon mundësinë për të organizuar tubimin.</li> <li>5) Nuk ka përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë këtu edhe ndalimin apo dënimin e organizatorëve dhe pjesëmarrësve.</li> <li>6) Media duhet të ketë qasje sa më të madhe nëpër tubime.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• OShC-të nuk raportojnë asnjë kufizim të drejtës së tyre për tu tubuar</li> <li>• Tubimet publike zakonisht organizohen nëpër sheshe publike, derisa vendet tjera nuk janë të zakonshme për organizimin e tubimeve publike</li> <li>• Kundërtubimet nuk janë të zakonshme</li> <li>• Nuk ka raporte për përdorimin e forcës nëpër tubime publike të organizuara nga OShC-të</li> <li>• Në përgjithësi, mediat kanë qasje të plotë në tubime</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p>

## Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

### Nën-fusha 1.2.: Liritë e tjera

#### Parimi: Liritë e tubimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Përfaqësuesit e OShC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatës së tyre, gëzojnë lirinë e shprehjes.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Korniza ligjore siguron lirinë e shprehjes për të gjithë.</li> <li>2) Kufizimet, të tilla si kufizime të gjuhës së urrejtjes, të sanksionuara nga legjislacioni janë të përshkruara qartë dhe në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.</li> <li>3) Shpifja përbën një kundërvajtje e jo vepër penale.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore siguron të drejtën e shprehjes së lirë për të gjithë</li> <li>• Kufizimet janë të limituara vetëm ndaj fjalimeve që nxisin urrejtje, dhe si të tilla këto kufizime janë në pajtim me ligjet dhe standardet ndërkombëtare</li> <li>• Shpifja nuk është pjesë e kodit penal</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Përfaqësuesit e OShC-ve, sidomos të organizatave për të drejtat e njeriut dhe organizatave mbikëqyrëse, gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes në çështje që ata mbështesin dhe ndaj të cilave janë kritikë.</li> <li>2) Nuk ka raste të shkeljes të lirisë së shprehjes.</li> <li>3) Nuk ka raste ku individët, duke përfshirë përfaqësues të OShC-ve persekutohen për fjalime kritike, në publik apo private.</li> <li>4) Kodi penal nuk parasheh asnjë sanksion për fjalimin kritik, në publik apo privat.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfaqësuesit e OShC-ve, duke përfshirë këtu ata nga të drejtat e njeriut dhe OShC-ve mbikëqyrëse, në përgjithësi gëzojnë të drejtën e shprehjes së lirë</li> <li>• Ka pak raste të raportuara të cenimit të së drejtës së shprehjes së lirë për OShC-të nga institucionet publike, edhe pse ka një numër të rasteve të raportuara të cenimit të kësaj të drejte për gazetarë</li> <li>• Ka pak raste të raportuara të kërcënimit të përfaqësuesëve të OShC-ve për fjalimet e tyre kritike, ndërsa një numër të kërcënimeve të raportuar ndaj gazetarëve nga ana e zyrtarëve publike ose nga përfaqësues të biznesit</li> <li>• Nuk ka të raportuara raste të ndonjë sanksioni penal për fjalime kritike</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi gjyqësor dhe policia duhen të reagojnë në mënyrë më efektive në parandalimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj gazetarëve apo përfaqësuesëve të OShC-ve</li> </ul>

## Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

### Nën-fusha 1.2.: Liritë e tjera

#### Parimi: Liritë e tubimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë

STANDARDI 3	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
Përfaqësuesit e OShC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatës së tyre, kanë të drejtë të marrin dhe përçojnë informacion nëpërmjet çfarëdolloji të medieeve.	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Korniza ligjore ofron mundësinë për të komunikuar nëpërmjet dhe për të pasur qasje në çfarëdo burimi të informacionit, duke përfshirë internetin dhe Teknologjinë e Komunikimit të Informacionit (ICT); nëse ka kufizime ligjore këto janë të rralla, të kufizuara dhe në bazë të ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.</li> <li>2) Korniza ligjore ndalon mbikëqyrjen e pajustificuar të kanaleve të komunikimit, duke përfshirë internetin dhe ICT, ose mbledhjen e informacionit të përdoruesit nga ana e autoriteteve.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore siguron mundësinë e komunikimit përmes dhe qasjes në çfarëdo burim të informatave, duke përfshirë internetin dhe ICT</li> <li>• Korniza ligjore ndalon monitorimin e pajustificuar të kanaleve të komunikimit, përveç monitorimit të bazuar në vendim të gjykatës apo në situata ta jashtëzakonshme për arsye të sigurisë kombëtare</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Nuk ka raste të vendosjes së kufizimeve mbi qasjen në çfarëdo burimi të informacionit, përfshirë internetin apo ICT.</li> <li>2) Interneti është gjerësisht i qasshëm dhe i përballueshëm.</li> <li>3) Nuk ka asnjë praktikë apo raste monitorimi të pajustificuar nga ana e autoriteteve, të kanaleve të komunikimit duke përfshirë internetin apo ICT, ose mbledhjes së informacionit të përdoruesit.</li> <li>4) Nuk ka raste të ndalimit të anëtarëve të grupeve të rrjeteve sociale nga ana e policisë.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka raste të raportuara për ndonjë kufizimin të imponuar ndaj OShC-ve në qasjen në cilindo burim të informatave</li> <li>• Depërtimi i internetit në Kosovë është 72.1%, ndërsa pagesa mujore për lidhjen e internetit është rreth 4.5% të pagës mesatare mujore nga buxheti shtetëror</li> <li>• Ka pak raste të raportuara të monitorimit të kanaleve të komunikimit, edhe pse nuk ka dëshmi për arsyet e monitorimit</li> <li>• Nuk ka raste të raportuara të ndalimit të anëtarëve të grupeve sociale nga policia</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rastet e raportuara të monitorimit të kanaleve të komunikimit (kryesisht bisedave telefonike) duhen të hetohen dhe rezultatet e hetimit duhen të publikohen</li> </ul>

Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

Nën-fusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

Parimi: OShC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Ka lehtësira tatimore për disa burime të ardhurash për OShC-të.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ligji parashikon lirim nga tatimi për të gjitha grantet dhe donacionet që mbështesin aktivitetin jo-fitimprurës të OShC-ve.</li> <li>2) Ligji siguron lehtësira tatimore për aktivitetet ekonomike të OShC-ve.</li> <li>3) Ligji siguron lehtësira tatimore për investimet pasive të OShC-ve.</li> <li>4) Ligji lejon krijimin dhe siguron përfitime tatimore për fondet investive/të dhurimeve (endowments).</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji siguron lirimin nga tatimi për të gjitha grantet dhe donacionet që përkrahin aktivitetin jo-fitimprurës të OShC-ve</li> <li>• Ligji siguron lehtësime tatimore për aktivitete të ndërlidhura ekonomike të OShC-ve deri në “një nivel të arsyeshëm të të ardhurave”</li> <li>• Nuk ka dispozita ligjore specifike për trajtimin e investimeve pasive të OShC-ve</li> <li>• Nuk ka dispozita ligjore për themelimin dhe operimin e fondeve investive/të dhurimit</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore duhet në mënyrë të qartë t'i adresoj investimet pasive të OShC-ve</li> <li>• Korniza ligjore duhet të rregullojë qartë themelimin dhe operimin e fondeve investive/të dhurimit</li> </ul>
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Nuk është raportuar asnjë taksë mbi grantet, direkte ose indirekte (e fshehur).</li> <li>2) Lehtësirat tatimore për aktivitetet ekonomike të OShC-ve janë efektive dhe mbështesin funksionimin e OShC-ve.</li> <li>3) Investimet pasive shfrytëzohen nga OShC-të dhe nuk aplikohen sanksione për të tilla investime.</li> <li>4) Fondet investive/të dhurimeve krijohen pa vështirësi të mëdha procedurale dhe veprojnë lirisht, pa ndonjë barrë administrative apo kosto të lartë financiare.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk raportohet ndonjë tatim i drejtpërdrejtë apo indirekt në grante</li> <li>• Në përgjithësi, lehtësimet tatimore për aktivitetet ekonomike të OShC-ve janë efektive, edhe pse ka vështirësi në raportim për shkak të procedurave të raportimit të cilat nuk janë specifike për punën e OShC-ve</li> <li>• Investimet pasive nuk janë të zakonshme</li> <li>• Nuk janë hasur praktika të themelimit ose funksionimit të fondeve investive/të dhurimit</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedurat e raportimit të ndërlidhura me lehtësimet tatimore duhen të marrin parasysh natyrën specifike të punës së OShC-ve</li> </ul>



Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

Nën-fusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

Parimi: OShC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Ofrohen lehtësira fiskale për të nxitur dhurimet nga individët dhe korporatat.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ligji parashikon zbritje nga taksat për donacionet individuale apo nga korporatat për OShC-të.</li> <li>2) Ka kërkesa/ kushte të qarta për marrjen e donacioneve për të cilat ka zbritje nga taksat dhe këto përfshijnë një gamë të gjerë aktiviteteve në dobi të publikut.</li> <li>3) Politikat shtetërore në lidhje me përgjegjshmërinë sociale të korporatave (CSR) marrin parasysh nevojat e OShC-ve dhe i përfshijnë ato në programet e tyre.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji siguron zbritje tatimore për donacione individuale dhe të korporatave për OShC-të deri në 5%</li> <li>• Kërkesat/kushtet ligjore për të pranuar donacione të zbritshme janë të qarta, por përfshijnë vetëm një numër të vogël të aktiviteteve të dobishme për publikun</li> <li>• Nuk ka politika shtetërore për përgjegjshmërinë sociale të korporatave (CSR)</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi për zbritje të tatimit për donacione individuale dhe të korporatave duhet të ndryshohet sa i përket shkallës dhe gamës së zbritjeve dhe mekanizmave të saj zbatues</li> <li>• Zbritjet nga tatimi duhen të jenë të mundshme për të gjitha aktivitetet nga të cilat përfiton publiku dhe Ligjet për tatime duhen të harmonizohen me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ – kapitulli për organizatat me Status për Përfitim Publik</li> <li>• Duhet inicuar politika për përgjegjshmërinë sociale të korporatave, në bashkëpunim me OShC-të</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ekziston një procedurë funksionale për të kërkuar zbritje taksash për donacione individuale apo të korporatave.</li> <li>2) OShC-të janë partnerë me shtetin në promovimin e CSR.</li> <li>3) OShC-të që punojnë në fushat kryesore të interesit publik, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe organizatat mbikëqyrëse, përfitojnë donacione për të cilat aplikohet ulje taksash.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekziston një procedurë për kërkimin e zbritjeve tatimore, edhe pse përdoret në raste të rralla</li> <li>• OShC-të dhe shteti nuk janë aktiv në promovimin e CSR</li> <li>• Pak OShC kanë pranuar donacione individuale apo nga korporatat, dhe zbritjet tatimore nuk janë motivimi kryesor për këto donacione</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësia e zbritjeve tatimore duhet të promovohet dhe procedura për këtë duhet të thjeshtësohet</li> <li>• CSR duhet të promovohet nga autoritetet shtetërore, në bashkëpunim me OShC-të</li> </ul>
--	--	---	--

## Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

### Nën-fusha 2.2.: Përkrahja shtetërore

**Parimi: Përkrahja shtetërore për OShC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme**

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Ka fonde publike në dispozicion për zhvillimin institucional të OShC-ve, mbështetje të projekteve dhe bashkë-financim të granteve të BE-së dhe të tjera.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ka një ligj apo politikë kombëtare (dokument), që rregullon përkrahjen shtetërore për zhvillimin institucional të OShC-ve, mbështetje për projektet dhe bashkë-financimin e projekteve të financuara nga BE.</li> <li>2) Ekziston një mekanizëm në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OShC-të.</li> <li>3) Fondet publike për OShC-të planifikohen në mënyrë të qartë në buxhetin e shtetit.</li> <li>4) Ka procedura të qarta për pjesëmarrjen e OShC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka ligj apo politikë/dokument kombëtar i cili e rregullon përkrahjen shtetërore për OShC-të</li> <li>• Nuk ka mekanizëm të nivelit kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike të OShC-ve</li> <li>• Fondet publike për OShC-të nuk janë të planifikuara qartë përbrenda buxhetit shtetëror</li> <li>• Ligji e lejon mundësinë e drejtimit të fondeve të lotarisë për grupe të ndryshme sociale, çështje të të drejtave të njeriut, kulturë dhe sport, mirëpo nuk ekzistojnë procedurat për këtë</li> <li>• Nuk ka procedura për pjesëmarrjen e OShC-ve në ciklin e financimit publik</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të iniciohet një sistem gjithëpërfshirës i financimit publik, bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Fondet publike në dispozicion u përgjigjen nevojave të sektorit të shoqërisë civile</li> <li>2) Ekzistojnë organe qeveritare me një mandat të qartë për shpërndarjen dhe / ose mbikëqyrjen e shpërndarjes së fondeve shtetërore.</li> <li>3) Financimi është i parashikueshëm, jo i zvogëluar në mënyrë drastike nga njëri vit në tjetrin, dhe shuma e buxhetit për OShC është lehtësisht e identifikueshme.</li> <li>4) Pjesëmarrja e OShC-ve në ciklin e financimit publik është transparente dhe kuptimplotë.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Financimi publik është në dispozicion, mirëpo nuk i përgjigjet nevojave të sektorit të OShC-ve</li> <li>• Asnjë trup qeveritar nuk e ka mandatin të shpërndajë dhe monitorojë shpërndarjen e fondeve shtetërore</li> <li>• Financimi nuk është i planifikuar dhe i parashikueshëm dhe shuma e buxhetit për OShC është e pamundur të identifikohet</li> <li>• Nuk ekzistojnë informata në lidhje me mbledhjen apo shpërndarjen e fondeve të lotarisë</li> <li>• Nuk ka pjesëmarrje të OShC-ve në ciklin e financimit publik</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Financimi publik për OShC-të duhet të bëhet transparent menjëherë, pavarësisht sistemit gjithëpërfshirës të financimit publik</li> <li>• Financimi publik për OShC-të duhet të planifikohet paraprakisht</li> <li>• OShC-të duhen të jenë pjesë e hartimit dhe zbatimit të sistemit gjithëpërfshirës për financimin publik, në pajtim me standardet e Matricës monitoruese</li> </ul>
--	---	--	--

## Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

### Nën-fusha 2.2.: Përkrahja shtetërore

#### Parimi: Përkrahja shtetërore për OShC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Fondet publike shpërndahen në një mënyrë të përcaktuar dhe transparente.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike është transparente dhe ligjërish detyruese për palët.</li> <li>2) Kriteret për përzgjedhje janë të qarta dhe të publikuara paraprakisht.</li> <li>3) Ekzistojnë procedura të qarta që adresojnë çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka procedurë specifike për shpërndarjen e fondeve publike të OShC-të</li> <li>• Nuk ka kriteret standarde të përzgjedhjes dhe institucione të ndryshme shtetërore përdorin kriteret të ndryshme të përzgjedhjes</li> <li>• Të vetmet procedura specifike për OShC-të për adresimin e konfliktit të interesit në lidhje me financimin nga shteti janë të ndërlidhura me zyrtarët publik si anëtarë të bordeve</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një sistem gjithëpërfshirës për financimin publik duhet të iniciohet, duke u bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> <li>• Sistemi gjithëpërfshirës për financimin publik duhet të ketë procedurë të qarta për</li> </ul>

			adresimin e konfliktit të interesit
	<b>Praktika:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Informacioni lidhur me procedurat për financim dhe informacioni mbi projektet e financuara është në dispozicion të publikut.</li> <li>2) Organet shtetërore ndjekin procedurën dhe e aplikojnë atë në një mënyrë të harmonizuar.</li> <li>3) Kërkesat e aplikimit nuk përbëjnë barrë për OShC-të.</li> <li>4) Vendimet mbi tenderët konsiderohen të drejta dhe konfliktet e interesit shpallen paraprakisht.</li> </ol>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informatat në lidhje me procedurat dhe projektet e financuara janë në dispozicion publik vetëm në raste të rralla</li> <li>• Trupat shtetërorë nuk kanë dhe nuk zbatojnë procedura të harmonizuara</li> <li>• Nuk ka informata të mjaftueshme që do të mundësonin vlerësimin dhe raportimin e kërkesave të aplikimit</li> <li>• Shumica e vendimeve për tenderë nuk janë transparente dhe nuk ka informata në dispozicion për drejtësinë e vendimeve dhe konfliktin e interesit</li> </ul>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjitha informatat për financimin publik duhen të jenë publike në mënyrë adekuate dhe në kohë të duhur</li> <li>• Kërkesat e tashme për aplikim duhen të jenë publike</li> <li>• Vendimet për dhënien e fondeve publike duhen të merren nga borde të pavarura, të cilat gjithashtu duhet të përfshijnë përfaqësues të OShC-ve</li> </ul>

## Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

### Nën-fusha 2.2.: Përkrahja shtetërore

#### Parimi: Përkrahja shtetërore për OShC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme

STANDARDI 3	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
Ekziston një sistem i qartë për llogaridhënien, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e fondeve publike.	<b>Legjislacioni:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike parashikon masa të qarta për llogaridhënien, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e tyre.</li> <li>2) Ka sanksione për OShC-të që keqpërdorin fondet dhe ato janë në proporcion me shkeljen.</li> </ol>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka procedura dhe masa specifike që të sigurohet llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i financimit publik të OShC-ve, përveç dispozitave të përgjithshme të Ligjit për prokurimin publik dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësi</li> <li>• Nuk ka sanksione specifike për OShC-të të cilat keqpërdorin fondet, përveç dispozitave të përgjithshme të Ligjit për prokurimin publik dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe</li> </ul>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Masa dhe procedura specifike sa i përket llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimit publik të OShC-ve duhen të jenë pjesë e sistemit të ri gjithëpërfshirës për financimin publik të OShC-ve</li> </ul>

		përgjegjëse	
	<b>Praktika:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Mbikëqyrja kryhet vazhdimisht dhe në përputhje me indikatorët objektivë dhe të paracaktuar.</li> <li>2) Vlerësimi i rregullt i efekteve/ndikimit të fondeve publike kryhet nga organet shtetërore dhe është në dispozicion të publikut.</li> </ol>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka vizita të monitorimit të standardizuara për OShC-të të cilat marrin fonde publike</li> <li>• Nuk kryhet vlerësimi i fondeve publike për OShC-të</li> </ul>	<b>Praktika:</b>

## Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

### Nën-fusha 2.2.: Përkrahja shtetërore

**Parimi: Përkrahja shtetërore për OShC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme**

STANDARDI 4	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
Ekziston mbështetje jo-financiare nga shteti.	<b>Legjislacioni:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Legjislacioni lejon autoritetet shtetërore të japin mbështetje jo-financiare, si psh. pronë shtetërore, marrje me qera të hapësirës pa kompensim financiar (e afatizuar), trajnime, konsultime dhe burime të tjera falas për OShC-të.</li> <li>2) Mbështetja jo-financiare ofrohet në bazë të procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë, duke u bazuar në kritere objektive dhe pa privilegjuar asnjë grup.</li> </ol>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji lejon komunat t'u ndajë OShC-ve prona të paluajtshme</li> <li>• Ka kritere shumë të përgjithësuara dhe nuk ka proces të përshkruar qartë për përkrahjen jofinanciare të OShC-ve</li> </ul>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme duhet të ndryshohet që të sigurohen mundësi të barabarta për të gjitha OShC-të si dhe të sigurohet një proces transparent dhe i definuar qartë i vendimarrjes</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) OShC-të marrin mbështetje jo-financiare nga shteti.</li> <li>2) OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë ose përfitojnë më shumë mbështetje në krahasim me aktorët e tjerë, kur ofrohen burime jo-financiare shtetërore.</li> <li>3) Nuk ka raste kur autoritetet shtetërore që ofrojnë mbështetje jo-financiare vetëm për OShC-të që nuk kritikojnë punën e tyre; ose e rasteve të privimit të mbështetjes për OShC-të kritike; ose diskriminim tjetër bazuar në besnikërinë, përkatësinë politike ose baza të tjera të paligjshme.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ka një numër të OShC-ve të cilat përdorin përkrahjen jofinanciare nga komunat</li> <li>• Nuk ka raporte të trajtimit të pabarabartë të OShC-ve në krahasim me aktorët tjerë</li> <li>• Përkrahja jofinanciare kryesisht u jepet OShC-ve të cilat përfaqësojnë grupet e marginalizuara dhe organizatat rinore, derisa raportohen vetëm pak raste ku OShC-të kritike kanë përfituar nga përkrahje ad-hoc apo afatshkurtër jofinanciare</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përkrahja jofinanciare për OShC-të duhet të zgjerohet përtej OShC-ve të cilat përfaqësojnë grupet e marginalizuara dhe organizatat rinore</li> </ul>
--	---	--	---

## Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

### Nën-fusha 2.3: Burimet njerëzore

#### Parimi: Politikat shtetërore dhe ambienti ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera në OShC

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënës të tjerë.	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ligji dhe politikat i trajtojnë OShC-të në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit tjerë sipas ligjit</li> <li>• OShC-të kanë vështirësi në zbatimin e dispozitave të Ligjit të punës në lidhje me pushimin e lehonisë, për shkak të natyrës së tyre specifike të financimit</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimi i Ligjit të punës duhet të përfshijë OShC-të në mënyrë që të shqyrtohen dhe adresohen zgjidhjet e pushimit të lehonisë për punëtorët e OShC-ve</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Nëse ka programe shtetërore për nxitje të punësimit, OShC-të trajtohen njësoj si të gjithë sektorët e tjerë.</li> <li>2) Ka statistika të rregullta mbi numrin e të punësuarve në sektorin jo-fitimprurës.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• OShC-të nuk trajtohen nëpër programe punësimi të nxitura nga shteti</li> <li>• Nuk ka statistika për numrin e punëtorëve në sektorin jofitimprurës</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kur bëhet dizajnimi i politikave të punësimit, shteti duhet njohë shoqërinë civile si një prej sektorëve të cilët gjenerojnë punësim, dhe si rrjedhojë duhet t'i përfshijë OShC-të në programet e punësimit të nxitura nga shteti</li> <li>• Enti Statistikor i Kosovës, Ministria e Punës dhe Administrata Tatimore duhen t'i përfshijnë OShC-të si kategori e statistikave në statistikat e tyre të punësimit</li> </ul>
--	---	--	---

**Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të**

**Nën-fusha 2.3: Burimet njerëzore**

**Parimi: Politikat shtetërore dhe ambienti ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera në OShC**

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Legjislacioni stimulon vullnetarizmin dhe përfshin praktikën më të mirë rregullative, duke lejuar në të njëjtën kohë për praktika spontane vullnetarizmi.</li> <li>2) Ekzistojnë stimuj dhe programe të mbështetura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit.</li> <li>3) Ekzistojnë marrëdhënie kontraktuale të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe mbrojtje për vullnetarizmin e organizuar.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni nxit punën vullnetare vetëm për rininë, dhe regjistrimi i vullnetarëve rinor është i obligueshëm</li> <li>• Pothuajse fare s'ka nxitje dhe programe të përkrahura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e punës vullnetare rinore</li> <li>• Ka obligime ligjore për marrëdhëniet kontraktuale dhe mbrojtjen e vullnetarëve të organizuar rinor</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një sistem gjithëpërfshirës për punën vullnetare duhet të iniciohet, bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe me përfshirjen e fushave tjera përtej punës vullnetare</li> </ul>



			rinore
	<b>Praktika:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Stimujt dhe programet janë transparente dhe lehtësisht të disponueshme nga OShC-të, ndërsa politika/dokumenti strategjik/ligji zbatohet plotësisht, mbikëqyret dhe vlerësohet periodikisht në mënyrë pjesëmarrëse.</li> <li>2) Procedurat administrative për organizatorët e aktiviteteve vullnetare ose për vullnetarët nuk janë të komplikuar dhe janë pa ndonjë kosto të panevojshme.</li> <li>3) Vullnetarizmi mund të bëhet në çfarëdo forme, nuk ka raste ankesash mbi kufizimet ndaj vullnetarizmit.</li> </ol>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pothuajse s'ka fare nxitje dhe programe për punën vullnetare rinore, dhe dispozitat për punën vullnetare rinore nuk zbatohen</li> <li>• Procedurat administrative për organizatat nikoqire të vullnetarëve rinor janë të koklavitura dhe të rënda për OShC-të</li> <li>• Vullnetarizmi mund të ndodh në çfarëdo forme, pa ndonjë procedurë formale</li> </ul>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedurat administrative për organizatat nikoqire të vullnetarëve rinor duhen të thjeshtësohen</li> </ul>

## Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OShC-të

### Nën-fusha 2.3: Burimet njerëzore

#### Parimi: Politikat shtetërore dhe ambienti ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera në OShC

STANDARDI 3	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
Sistemi arsimor promovon angazhimin qytetar.	<b>Legjislacioni:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Arsimi joformal promovohet nëpërmjet politikave strategjive/ligjeve.</li> <li>2) Lëndë të lidhura me shoqërinë civile janë të përfshira në plan-programin zyrtar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor.</li> </ol>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Edukimi joformal promovohet përmes ligjit dhe legjislacionit dytësor në fushën e rinisë, derisa Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit e njeh edukimin joformal në disa fusha</li> <li>• Tema të pakta që ndërlidhen me shoqërinë civile janë të përfshira në programin mësimor zyrtar të sistemit të arsimit</li> </ul>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Politikat për edukimin joformal duhen të dizajnohen me pjesëmarrjen e OShC-ve dhe të përfshijnë fusha të tjera e jo vetëm atë të rinisë</li> <li>• Lëndë të ndërlidhura me shoqërinë civile duhen të përfshihen në programin mësimor zyrtar të sistemit të arsimit, në bashkëpunim me OShC-të</li> </ul>

	<b>Praktika:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Sistemi arsimor përfshin mundësi për angazhim qytetar në OShC.</li> <li>2) Ofrimi i arsimit jo-formal nga OShC-të njihet.</li> </ol>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Disa universitete private sigurojnë mundësi për studentët e tyre të angazhohen me OShC</li> <li>• Edukimi joformal i dhënë nga OShC-të mund të njihet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit. Në praktikë, vetëm disa OShC të cilat kryejnë trajnime profesionale janë të akredituara përmes kësaj kornize</li> <li>• Edukimi joformal për të rinj është i njohur ligjërisht, edhe pse kriteret ekzistuese janë të rënda dhe burokratike dhe mundësia e njohjes së tillë nuk shfrytëzohet</li> </ul>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Universitetet publike dhe shkollat e mesme duhen të jenë proaktive në bashkëpunimin me OShC-të për të siguruar mundësi për angazhimin e studentëve të tyre në OShC</li> </ul>
--	---	--	---

### Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

#### Nën-fusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim

**Parimi: Ekziston një qasje strategjike për të çuar më tej bashkëpunimin në mes të autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile dhe për zhvillimin e shoqërisë civile**

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
Shteti njih, përmes politikave dhe strategjive, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të.	<b>Legjislacioni:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ekzistojnë dokumente strategjike që kanë të bëjnë me marrëdhëniet në mes të autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile dhe zhvillimin e shoqërisë civile.</li> <li>2) Dokumenti strategjik përfshin qëllimet dhe masat, financimin në dispozicion, si dhe ndarje të qartë të përgjegjësive (plane veprimi, përfshirë indikatorët).</li> <li>3) Dokumenti strategjik përfshin masa që janë zhvilluar në konsultim me dhe/ose të rekomanduara nga OShC-të.</li> </ol>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një Strategji qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është miratuar kohëve të fundit, derisa iniciativa e formalizimit të bashkëpunimit të Kuvendit e Kosovës me shoqërinë civile është në vazhdim e sipër</li> <li>• Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile përfshin masat dhe objektivat strategjike, si dhe planin specifik të veprimit me ndarje të përgjegjësive, mirëpo pa fonde të ndara specifike për zbatimin e saj</li> <li>• Masat brenda Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile janë zhvilluar bashkërisht me OShC-të</li> </ul>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të ketë fonde specifike të ndara për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) OShC nga fusha të ndryshme marrin pjesë rregullisht në të gjitha fazat e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të dokumentit, strategjik.</li> <li>2) Ka shumë shembuj që tregojnë se bashkëpunimi mes shtetit dhe OShC-ve dhe zhvillimi i shoqërisë civile është përmirësuar dhe zbatohet në përputhje me/ose përtej masave të parashikuara në dokumentin strategjik.</li> <li>3) Zbatimi i dokumentit strategjik është mbikëqyrur, vlerësuar dhe rishikuar periodikisht.</li> <li>4) Politikat shtetërore për bashkëpunim midis autoriteteve shtetërore dhe OShC-ve dhe për zhvillimin e shoqërisë civile janë të bazuara në të dhëna të besueshme të mbledhura nga statistikat kombëtare, duke marrë parasysh larminë e sektorit.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumë OShC nga fusha të ndryshme të interesit kanë marrë pjesë në zhvillimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> <li>• Pasi që kjo Strategji është miratuar kohëve të fundit, nuk ekzistojnë ende shembuj konkret të përmirësimit të marrëdhënieve si rezultat i kësaj strategjie</li> <li>• Strategjia qeveritare parasheh monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim dhe rishikim të kohëpaskohshëm, mirëpo asnjëra nga këto nuk ka filluar deri më tani</li> <li>• Strategjia qeveritare është bazuar në të dhëna të mbledhura kryesisht nga vet OShC-të</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të ketë vullnet politik më të shprehur për zbatimin e duhur të Strategjisë</li> <li>• Duhet të ketë edukim të vazhdueshëm dhe ngritje të kapaciteteve për shërbyesit civil për këtë Strategji dhe rolin e tyre në zbatimin e saj</li> <li>• Enti Statistikor i Kosovës duhet të bashkëpunojë me OShC-të që merren me zhvillimin e shoqërisë civile në mbledhjen dhe publikimin e të dhënave relevante për sektorin e shoqërisë civile</li> </ul>
--	---	--	---

### Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

#### Nën-fusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim

**Parimi: Ekziston një qasje strategjike për të çuar më tej bashkëpunimin në mes të autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile dhe për zhvillimin e shoqërisë civile**

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Shteti njuh, përmes veprimit të institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ekziston një institucion në nivel kombëtar ose mekanizëm me një mandat për të lehtësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile (p.sh., Njësia/Zyra për bashkëpunim; pikat e kontaktit në ministri, këshill për bashkëpunim).</li> <li>2) Ka dispozita të detyrueshme për përfshirjen e OShC-ve në vendimet e marra nga institucioni kompetent apo mekanizmi(at).</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit (ZKM/ZQM) e ka mandatin të lehtësoj bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile</li> <li>• Një zyrtar ndërlidhës për shoqërinë civile është emëruar përbrenda administratës së Kuvendit të Kosovës</li> <li>• Një Këshill i përbashkët për implementimin e</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit duhet të themelojë një njësi të veçantë për bashkëpunim me shoqërinë civile, me mandat specifik ta lehtësojë bashkëpunimin</li> </ul>

		<p>Strategjisë është paraparë të themelohet së shpejti</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Strategjia qeveritare parasheh konsultime të vazhdueshme me OShC-të për të gjitha çështjet e lidhura me bashkëpunimin në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile</li> </ul>	<p>në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile</p>
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Institucioni i nivelit kombëtar apo mekanizmi(at) kanë burime të mjaftueshme dhe mandat për lehtësimin e dialogut Qeveri – shoqëri civile, për të diskutuar sfidat dhe propozuar politikat kryesore për zhvillimin e shoqërisë civile.</li> <li>2) OShC të konsultohen rregullisht dhe përfshihen në proceset dhe vendimet e institucionit kompetent ose mekanizmit(ave).</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ZQM/ZKM nuk ka burime të mjaftueshme për lehtësimin e dialogut Qeveri-shoqëri civile, përfshirë këtu edhe sa i përket mandatit për të shërbyer si sekretariat për Këshillin e përbashkët</li> <li>• Pozita e zyrtarit ndërlidhës për shoqërinë civile e Kuvendit të Kosovës ende nuk ka prodhuar ndonjë përmirësim në marrëdhëniet e shoqërisë civile dhe Kuvendit</li> <li>• OShC-të rregullisht janë të përfshira në hartimin dhe vendimet e Zyrës për Qeverisje të Mirë në lidhje me zbatimin e strategjisë, përfshirë këtu hartimin e termave të referencës për Këshillin e përbashkët</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra për Qeverisje të Mirë duhet t'i ngrit kapacitetet e saja financiare dhe njerëzore për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> </ul>

### Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

#### Nën-fusha 3.2: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes

Parimi: OShC-të janë të përfshira në mënyrë efektive në procesin e hartimit të politikave dhe vendim-marrje

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Ekzistojnë standarde që mundësojnë përfshirjen e OShC-ve në vendim-marrje, të cilat lejojnë kontributin e OShC-ve në kohën e duhur.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ekzistojnë standarde të përcaktuara qartë për përfshirjen e OShC-ve në proceset vendimmarrëse dhe të hartimit të politikave, në përputhje me praktikën më të mira rregullatore që përshkruajnë kërkesat minimale që çdo proces politikë-bërës duhet të përmbushë.</li> <li>2) Politikat shtetërore parashikojnë programe edukative/ trajnime për nëpunësit civilë për përfshirjen e OShC-ve në punën e institucioneve publike.</li> <li>3) Rregulloret e brendshme kërkojnë që njësi të specifikuar ose zyrtarë në Qeveri, ministritë e linjës apo agjenci të tjera qeveritare të koordinojnë, mbikëqyrin dhe raportojnë përfshirjen e OShC-ve në punën e tyre.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullorja e punës e Qeverisë kërkon konsultime publike për të gjitha draft politikat/ligjet, përderisa ende nuk ka të përcaktuara kurrfarë kërkesa minimale për këtë proces</li> <li>• Ligji për vetëqeverisje lokale parashih instrumente të pjesëmarrjes së qytetarëve në nivelin lokal të vendimmarrjes</li> <li>• Rregullorja e Punës e Kuvendit siguron mundësi të padetyrueshme për përfshirjen e OShC-ve në punën e komisioneve parlamentare</li> <li>• Nuk ka programe edukative/trajnime për shërbyesit civil në përfshirjen e OShC-të, por kjo është pjesë e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> <li>• Rregulloret e brendshme nuk kanë kërkesa për njësi/zyrtar specifik që të koordinojnë, monitorojnë dhe raportojnë përfshirjen e OShC-ve në punën e tyre, por kjo është pjesë e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni duhet të përfshijë standardet minimale për konsultime publike në nivelin qeveritar</li> <li>• Kërkesat për përfshirjen e OShC-ve duhet të përfshijnë të tërë ciklin e vendimmarrjes, duke filluar nga caktimi i agjendës e deri te riformulimi</li> <li>• Kuvendi duhet të hartojë kërkesa detyruese për përfshirjen e OShC-ve në punën e Komisioneve të Kuvendit</li> <li>• Institucionet publike duhet të emërojnë njësitë/zyrtarët specifik për përfshirjen e OShC-ve, si dhe të dizajnojnë programe për ngritjen e kapaciteteve të tyre</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Institucionet publike në mënyrë rutinore ftojnë të gjitha OShC-të e interesuara për të komentuar mbi politika/nisma ligjore, në një fazë të hershme.</li> <li>2) OShC-ve u ofrohet informacion adekuat për përmbajtjen e draft dokumenteve dhe detajet e konsultimeve, me kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur.</li> <li>3) Institucionet publike bëjnë publike informacione të shkruara mbi rezultatet e konsultimeve, duke përfshirë arsyet përse disa rekomandime nuk janë përfshirë.</li> <li>4) Shumica e nëpunësve civilë të ngarkuar me hartimin e politikave publike kanë përfunduar me sukses programet e nevojshme arsimore/trajnuese.</li> <li>5) Shumica e njëjësive/zyrtarëve që merren me koordinimin dhe mbikëqyrjen e konsultimeve publike janë funksionale dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucionet publike, sidomos ministritë, në shumë raste i ftojnë OShC-të të paraqesin komente me shkrim për draft ligjet/politikat, edhe pse jo në fazat e hershme të hartimit</li> <li>• Shumica e komunave nuk e përfshijnë shoqërinë civile rregullisht dhe shumë prej instrumenteve ligjore për pjesëmarrje nuk janë funksionalizuar si duhet</li> <li>• Komisionet e Kuvendit organizojnë dëgjime publike vetëm për disa draft ligje në procedurë</li> <li>• Në shumicën e rasteve OShC-ve nuk u janë dhënë informata adekuate për përmbajtjen e draft dokumentit dhe koha e zakonshme për t'iu përgjigjur ftesës nga ministritë është 15 ditë pune</li> <li>• Ka pak raste kur informatat kthyes me shkrim për rezultatet e konsultimeve jepen apo vihen në dispozicion të publikut</li> <li>• Ka shumë pak shërbyes civil përgjegjës për hartimin e politikave publike të cilët kanë mbaruar ndonjë program edukimi/trajnim për përfshirjen e OShC-ve</li> <li>• Nuk ka njësi/zyrtar të cilët koordinojnë dhe monitorojnë konsultimet publike</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministritë duhet t'i ftojnë OShC-të të paraqesin komente me shkrim qysh në fazat e hershme të hartimit të dokumenteve</li> <li>• Ministritë duhen të përdorin formatin e rekomanduar për konsultime me shkrim, me informata adekuate për përmbajtjen e draft dokumentit</li> <li>• Komisionet e Kuvendit duhet të organizojnë dëgjime publike për të gjitha draft ligjet në proces</li> <li>• Obligimi për informata kthyes duhet të zbatohet nga qeveria</li> <li>• Qeveria duhet të bashkëpunojë me shoqërinë civile në ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civil në përfshirjen e OShC-ve</li> </ul>
--	---	--	--

Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nën-fusha 3.2: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes

Parimi: OShC-të janë të përfshira në mënyrë efektive në procesin e hartimit të politikave dhe vendim-marrje

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Të gjitha draft politikat dhe ligjet janë lehtësisht të qasshme për publikun në kohën e duhur.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Legjislacioni ekzistues obligon institucionet shtetërore për të bërë publike të gjitha projektligjet dhe ligjet e politikave e miratuara, ndërsa përjashtimet janë përcaktuar qartë dhe në përputhje me normat ndërkombëtare dhe praktikave më të mira.</li> <li>2) Ekzistojnë mekanizma dhe procedura të qarta për qasje në informata/dokumente me karakter publik.</li> <li>3) Ekzistojnë sanksione të përshkruara qartë për nëpunësit civilë/njësitë për shkeljen e kërkesave ligjore për qasje në informata me karakter publik.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni ekzistues nuk i obligon shprehimisht institucionet publike që në mënyrë proaktive t'i publikojnë draftet e ligjeve dhe politikave, përderisa i obligon ata t'i publikojnë ligjet dhe politikave e miratuara</li> <li>• Ka mekanizma dhe procedura ligjore të qarta për qasje në informata/dokumente publike</li> <li>• Ligji qartë përshkruan sanksione me të holla për shërbyesit civil dhe institucionet që i shkelin kërkesat ligjore për qasje në informata publike</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji 03/L-215 për qasje në dokumente publike duhet të ndryshohet që t'i obligojë institucionet publike që gjithashtu t'i bëjnë publike draft ligjet/politikave dhe nismat ligjore</li> </ul>
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Institucionet publike në mënyrë aktive publikojnë projektligje dhe ligje e politika të miratuara, përveç atyre që u nënshtrohen përjashtimeve të përcaktuara me ligj.</li> <li>2) Institucionet publike u përgjigjen shumicës së kërkesave për qasje në informacionin publik brenda afatit të përcaktuar me ligj, në një format të qartë, japin shpjegime me shkrim mbi arsyet e refuzimit, dhe theksojnë të drejtën e ankesës dhe procedurë e ankesës.</li> <li>3) Rastet e shkeljeve të ligjit sanksionohen.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucionet publike në mënyrë aktive i publikojnë vetëm ligjet dhe politikave e miratuara, derisa draft ligjet nuk publikohen në mënyrë proaktive</li> <li>• Institucionet publike nuk u përgjigjen rregullisht e brenda afatit kohor kërkesave për qasje në informata publike, dhe shpjegimet për arsyet e refuzimit janë shumë të rralla</li> <li>• Nuk ka raporte se janë sanksionuar rastet e shkeljes së ligjit nga ana e zyrtarëve</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucionet publike duhet t'i përgjigjen kërkesave brenda afatit kohor dhe çfarëdo refuzimi duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim mbi arsyet e refuzimit</li> <li>• Nëpunësit civil/institucionet të cilët shkelin kërkesat ligjore duhen të sanksionohen</li> </ul>



Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nën-fusha 3.2: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes

Parimi: OShC-të janë të përfshira në mënyrë efektive në procesin e hartimit të politikave dhe vendim-marrje

STANDARDI 3	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Përfaqësuesit e OShC-ve janë partnerë të barabartë në diskutimet në organet ndër-sektoriale dhe janë zgjedhur nëpërmjet kriterëve dhe proceseve të përcaktuara qartë.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Legjislacioni ekzistues kërkon që institucionet publike të ftojnë përfaqësuesit e OShC-ve në trupa të ndryshme vendim-marrëse dhe/ose këshilluese të krijuara nga institucionet publike.</li> <li>2) Ka udhëzime të qarta se si të sigurohet përfaqësimi i duhur nga shoqëria civile, bazuar në kriterë transparente dhe të paracaktuara.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni ekzistues i lejon por nuk i obligon institucionet publike t'i ftojnë përfaqësuesit e OShC-ve nëpër trupa këshillues apo vendimmarrës të krijuara nga institucionet publike</li> <li>• Nuk ka mekanizma për përzgjedhje apo udhëzues standard të përzgjedhjes së përfaqësuesëve nga shoqëria civile. Disa trupa, përdorin mekanizma përzgjedhës të krijuar për nevoja specifike të këtyre trupave</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullorja e punës e Qeverisë dhe Ligji për vetëqeverisje lokale duhet të ndryshohet që t'i obligojë institucionet publike t'i ftojnë përfaqësuesit e OShC-ve nëpër trupa vendimmarrës/këshillues</li> <li>• Duhet dizajnuar mekanizma të përgjithshëm të përzgjedhjes nga Qeveria, për t'u mundësuar pastaj të gjitha institucioneve publike t'i aplikojnë ato me përshtatje specifike</li> </ul>

	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Trupat vendim-marrëse dhe këshilluese për çështjet dhe politikat që lidhen me shoqërinë civile në përgjithësi përfshijnë përfaqësuesit e OShC-ve.</li> <li>2) Përfaqësuesit e OShC-ve në këto trupa kanë mundësi të paraqesin lirisht dhe të mbrojnë pozicionet e tyre, pa u sanksionuar.</li> <li>3) Përfaqësuesit e OShC-ve përzgjedhen përmes proceseve të drejta dhe transparente.</li> <li>4) Pjesëmarrja në këto trupa nuk i ndalon OshC -të të përdorin mënyra alternative të avokimit ose promovimin e qëndrimeve alternative të cilat nuk janë në përputhje me pozicionin e trupës përkatëse.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumë trupa vendimmarrës dhe këshillëdhënës përfshijnë përfaqësues të OShC-ve për çështje të ndryshme</li> <li>• Përfaqësuesit e OShC-ve nëpër këta trupa në përgjithësi janë të lirë t'i prezantojnë dhe mbrojnë qëndrimet e tyre, pa u sanksionuar</li> <li>• Vetëm një numër i vogël i trupave këshilluese dhe vendimmarrëse i kanë përzgjedhur përfaqësuesit nga OShC-të përmes një procesi të hapur të përzgjedhjes</li> <li>• OShC-të që marrin pjesë nëpër trupa vendimmarrës dhe këshillues në përgjithësi përdorin edhe mënyra tjera të avokimit të cilat nuk janë patjetër në përputhje me pozicionin e trupit përkatës</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ftesa dhe përzgjedhja e përfaqësuesve të OShC-ve nëpër trupa vendimmarrës dhe këshillues duhet të jenë transparente dhe publike në të gjitha rastet</li> </ul>
--	---	---	---

### Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

#### Nën-fusha 3.3: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

#### Parimi: Ekziston një ambient i favorshëm për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve

STANDARDI 1	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>OShC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe të konkurrojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë të shërbimeve.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Legjislacioni ekzistues lejon OShC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme si arsimit, shëndetësisë, shërbimet sociale.</li> <li>2) OShC-të nuk kanë pengesa për të ofruar shërbime të cilat nuk janë të përcaktuara me ligj (shërbime "shtesë").</li> <li>3) Legjislacioni ekzistues nuk rëndon me kërkesa shtesë për OShC-të, kërkesa që nuk ekzistojnë për ofruesit e tjerë të shërbimeve.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni i përgjithshëm lejon OShC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme, ndërsa legjislacioni specifik lejon që OShC-të të ofrojnë shërbime sociale</li> <li>• Ekzistojnë barrierat e fshehta ligjore në legjislacionin e përgjithshëm të cilat në disa raste parandalojnë OShC-të të jenë të përshtatshme për kontrata të ofrimit të</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për prokurimin publik duhet të ndryshohet që të lejoj certifikatat e regjistrimit të OJQ-ve të pranohen njëjtë si edhe certifikatat e regjistrimit të biznesit</li> </ul>

		<p>shërbimeve (p.sh. kërkesa e certifikatës së regjistrimit të biznesit)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka kërkesa shtesë ligjore për OShC-të në krahasim me ofruesit tjerë të shërbimeve, edhe pse kërkesat e përgjithshme nuk janë në pajtim me natyrën specifike të punës së OShC-ve, me përjashtim të ofrimit të shërbimeve sociale ku natyra specifike e punës së OShC-ve është pjesë e legjislacionit</li> </ul>	
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>OShC-të janë në gjendje të përfitojnë kontrata në konkurrencë me ofruesit e tjerë dhe janë të angazhuar në shërbime të ndryshme (p.sh. në fushën e arsimit, shëndetësisë, hulumtimit dhe trajnimeve).</li> <li>OShC-të janë të përfshira në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve (vlerësimin e nevojave, përcaktimin e shërbimeve që adresojnë më mirë nevojat, në mbikëqyrje dhe vlerësim).</li> <li>Në rastet kur kërkohet regjistrim/licensim, procedura për marrjen e licensës nuk është tepër e vështirë.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ka pak OShC të cilat janë në gjendje të marrin kontrata, kryesisht në shërbime sociale dhe fusha ku nuk ekzistojnë ofrues tjerë të shërbimeve</li> <li>OShC-të janë të përfshira në disa faza të zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve</li> <li>Regjistrimi dhe licencimi kërkohet për të gjitha shërbimet sociale, dhe procedura për t'i marr këto është e njëjtë me ofruesit tjerë të shërbimeve. Baza e re ligjore është në proces të hartimit.</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>OShC-të duhen të përfshihen në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve</li> <li>Baza e re ligjore për licencimin e shërbimeve sociale dhe ofruesve të tyre duhet të jetë në përputhje me parimet e caktuara në Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> </ul>

Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nën-fusha 3.3: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

Parimi: Ekziston një ambient i favorshëm për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve

STANDARDI 2	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Shteti angazhohet për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i ofruar për një periudhë afat-gjatë.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Buxheti parashikon fonde për lloje të ndryshme shërbimesh të cilat mund të ofrohen nga OShC-të, duke përfshirë këtu edhe financime disa-vjeçare.</li> <li>2) Nuk ka pengesa ligjore për OShC-të që të përfitojnë fonde publike për ofrimin e shërbimeve të ndryshme (qoftë përmes prokurimit ose nëpërmjet një forme tjetër kontraktimi apo mekanizmi të ofrimit të granteve).</li> <li>3) OShC-të mund të nënshkruajnë kontrata afatgjata për ofrimin e shërbimeve.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni obligon institucionet shtetërore të sigurojnë fonde vjetore për OShC-të të cila ofrojnë shërbime sociale</li> <li>• Nuk ka barriera ligjore për marrjen e fondeve publike për OShC-të të cilat ofrojnë shërbime sociale, derisa për OShC-të të cilat ofrojnë shërbime tjera të cilat bien nën Ligjin e përgjithshëm të prokurimit publik, ka barriera të fshehta</li> <li>• OShC-të mund të nënshkruajnë kontrata vjetore për ofrimin e shërbimeve sociale</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni duhet të ndryshohet ashtu që t'i obligojë institucionet shtetërore të lejojnë kontrata shumëvjeçare për OShC-të të cila ofrojnë shërbime sociale</li> </ul>
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) OShC-të janë përfitues të fondeve për shërbime.</li> <li>2) OShC-të marrin fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet bazë të shërbimeve të cilat janë kontraktuar t'i ofrojnë, duke përfshirë shpenzimet proporcionale institucionale (shpenzimet e menaxhimit).</li> <li>3) Nuk ka vonesa në pagesa dhe financimi është fleksibil, me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Disa OShC të cilat ofrojnë shërbime sociale marrin fonde publike për shërbimet e ofruara</li> <li>• OShC-të, në shumicën e rasteve, nuk marrin fonde të mjaftueshme që t'i mbulojnë shërbimet të cilat ata i ofrojnë, derisa shpenzimet institucionale në përgjithësi nuk mbulojnë</li> <li>• Shumë herë ka vonesa në pagesa dhe financimi nuk është fleksibil në raport me cilësinë e shërbimeve</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucionet shtetërore duhen të vendosin në dispozicion fonde të mjaftueshme për OShC-të që ta mbulojnë vlerën reale të shërbimeve të ofruara, si dhe të shpenzimeve institucionale të OShC-ve</li> <li>• Pagesat duhen të jenë të parashikueshme dhe të kryhen me kohë</li> </ul>

### Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

#### Nën-fusha 3.3: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

**Parimi: Ekziston një ambient i favorshëm për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve**

STANDARDI 3	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Shteti ka të përcaktuara procedura të qarta për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë përzgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OShC-të.</p>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ekziston një procedurë e qartë dhe transparente përmes të cilës ofruesëve të shërbimeve u shpërndahet financimi.</li> <li>2) Çmimi nuk është kriter kryesor për zgjedhjen e ofruesit të shërbimit dhe vlera më e mirë përcaktohet si nga cilësia e shërbimit ashtu edhe një vlerësim financiar i konkurrentit.</li> <li>3) Ka udhëzime të qarta se si të sigurohet transparenca dhe të shmangët konflikti i interesave.</li> <li>4) Ekziston e drejta për t'u ankuar kundër rezultateve të procedurës së ofertimit.</li> </ol>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nuk përfshin një procedurë të qartë e transparente përmes të cilës shpërndahen fondet publike për shërbime sociale</li> <li>• Dispozitat ligjore për kriteret e financimit përcaktohen në baza vjetore, përmes udhëzimeve specifike administrative</li> <li>• Ka dispozita të përgjithshme për adresimin e konfliktit të interesit</li> </ul>	<p><b>Legjislacioni:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedura për financimin e shërbimeve sociale nuk duhet të përcaktohet në baza vjetore, por procedurat standarde duhen të jenë pjesë e bazës ligjore</li> </ul>
	<p><b>Praktika:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Shumë shërbime u kontraktohen OShC-ve.</li> <li>2) Tenderët konsiderohen të drejtë dhe shmangët konflikti i interesit.</li> <li>3) Zyrtarët shtetërorë kanë kapacitete të mjaftueshme për të organizuar procedurat.</li> </ol>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Disa shërbime sociale u kontraktohen OShC-ve, ndërsa ka shumë pak lloje tjera të shërbimeve që u kontraktohen OShC-ve</li> <li>• Në praktikë, në shumicën e rasteve të ofrimit të shërbimeve sociale nga OShC-të, kriteri i përzgjedhjes është i bazuar në vlerën më të mirë në raport me cilësinë, ekspertizën teknike dhe vlerësimin financiar të konkurrentëve</li> <li>• Në disa raste, tenderët për ofrim të shërbimeve sociale nga OShC-të nuk konsiderohen të jenë në pajtim me kriteret e përzgjedhjes</li> <li>• OShC-të të cilat ofrojnë shërbime sociale konsiderojnë se zyrtarët shtetëror kanë kapacitete të mjaftueshme teknike për të</li> </ul>	<p><b>Praktika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitetet e zyrtarëve shtetëror që merren me ofrim të shërbimeve nga OShC-të duhen të ngriten, sidomos sa i përket konceptit të ofrimit të shërbimeve nga OShC-të</li> </ul>

		organizuar procedurat, mirëpo u mungon kuptimi i plotë i konceptit të ofrimit të shërbimeve nga OShC-të	
<b>Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile</b>			
<b>Nën-fusha 3.3: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve</b>			
<b>Parimi: Ekziston një ambient i favorshëm për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve</b>			
STANDARDI 4	INDIKATORËT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
Ekziston një sistem i qartë i llogaridhënies, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve.	<b>Legjislacioni:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ekziston mundësia ligjore për mbikëqyrjen si të shpenzimeve ashtu edhe të cilësisë së ofruesve të shërbimeve.</li> <li>2) Ekzistojnë standarde të qarta të cilësisë dhe procedura të mbikëqyrjes për shërbimet.</li> </ol>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ka bazë ligjore për monitorim të shpenzimeve të OShC-ve të cilat ofrojnë shërbime sociale</li> <li>• Nuk ka standarde për cilësinë dhe procedura të monitorimit për OShC-të ofruese të shërbimeve sociale, ndërsa hartimi i bazës ligjore është në proces</li> </ul>	<b>Legjislacioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i bazës ligjore për standarde të cilësisë dhe procedura të monitorimit duhet të përfshijnë OShC-të dhe të jetë në pajtim me parimet e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</li> </ul>
	<b>Praktika:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) OShC-të nuk janë subjekt i kontrollit të tepruar.</li> <li>2) Monitorimi kryhet mbi baza të rregullta, sipas procedurave dhe kriteve të njoftuara paraprakisht.</li> <li>3) Vlerësimi i rregullt i cilësisë dhe efekteve/ndikimit të shërbimeve të ofruara kryhet rregullisht, dhe ky vlerësim është në dispozicion të publikut.</li> </ol>	<b>Praktika:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në praktikë, ka vizita në terren/inspektime të cilat zakonisht janë të paralajmëruara</li> <li>• Vizitat në terren/inspektimet kryhen rregullisht, kryesisht sa i përket vërtetimit të shpenzimeve dhe aspekteve teknike të ofrimit të shërbimeve</li> <li>• Nuk bëhet vlerësimi i cilësisë dhe efekteve/ndikimeve të shërbimeve të ofruara</li> </ul>	<b>Praktika:</b>

# Lista e burimeve të shfrytëzuara

Gjatë hulumtimit të literatures janë shfrytëzuar burimet/dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës
- Ligji civil Nr. 02/L-62 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes
- Ligji Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare
- Ligji Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare
- Ligji nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (përfshirë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L 222)
- Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të terrorizmit (përfshirë Ligjin nr. 04/L-178 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit)
- Ligji Nr. 03/L-162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (përfshirë Ligjin nr. 04/L – 103 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave nr. 03/L – 162)
- Ligji Nr. 03/L-161për Tatimin në të Ardhurat Personale (përfshirë ligjin nr. 04/L – 104 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161për Tatimin në të Ardhurat Personale)
- Ligji Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike
- Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës
- Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë
- Ligji Nr. Nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012
- Ligji Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik
- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës
- Ligji Nr. 03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës
- Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat
- Ligji Nr. 03-L/040 për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike
- Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare
- Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushetit Lokal
- Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë
- Ligji Nr. 04/-L-025 për Nisma Legjislative
- Vendim shpjegues publik nr. 03/2013 për trajtimin tatimor të furnizimeve dhe importeve kur financohen drejtpërdrejtë nga Komisioni Europian
- Rregullorja nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive
- Rregullorja nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës
- Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Udhëzimi Administrativ nr. 10/2010 për Punën Vullnetare të të Rinjëve
- Udhëzimi Administrativ nr. 14/2010 për Zbatimin e Ligjit nr. 03/L-162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave



- Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2010 për Edukimin Joformal të të Rinjëve
- Udhëzim Administrativ Nr. 04/2011 për Ofrimin dhe Sigurimin e Përkrahjes Financiare të OJQ-ve vendore gjatë vitit 2011
- Udhëzim Administrativ Nr. 2008/09 për Transparencë në komuna
- Udhëzim Administrativ Nr. 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në komuna
- Regjistri i Departamentit për Regjistrimin e OJQ-ve
- Raportet vjetore të Avokatit të Popullit 2011 dhe 2012
- Kodi i mediave të shtypura të Kosovës
- Raportet e regjistrimit 2012 të Agjencisë së statistikave të Kosovës
- Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile
- Raporti vjetor i Qeverisë për Qasje në Dokumente Publike 2012
- Raporti Ex-officio i Avokatit të Popullit nr. 28/2012 lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar
- Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për statistikave të gjykatave të rregullta për vitin 2012
- Raporti i Freedom House "Liria në botë"
- Raporti i Organizatave të Mediave të Europës Juglindore (SEEMO) për Kosovën,
- Raportet e Civil Rights Defender
- Rekomandimi CM/Rec(2007)14 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi statusin ligjor të organizatave joqeveritare në Europë
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
- Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile
- Raportet e Asociacionit të Gazetarëve Profesionist të Kosovës
- Depërtimi dhe përdorimi i Internetit në Kosovë - Shoqata Kosovare për Teknologji të Informimit dhe Komunikimit (STIKK) 2013
- Raporti i Qendrës së Studimeve të Sigurisë të Kosovës mbi Monitorimin e Telekomunikacionit
- Pasqyrat financiare të Fondacionit IPKO për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012 (Raporti i auditimit)
- Indeksi i Transparencës së Institucioneve qendrore, lokale dhe ndërmarrjeve publike në Kosovë 2012, Lëvizja Fol

Vegëza të dobishme:

<http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Default.aspx>

[www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org)

[www.balkanicsd.net](http://www.balkanicsd.net)

# Shtojca 1 – Lista e të intervistuarëve

Sipas rendit alfabetik:

- Abetare Gojani Fondacioni IPKO
- Arben Lila Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC)
- Ajtene Shabani Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)
- Behxhet Binaku HANDIKOS
- Behxhet Gaxhiqi Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)
- Burim Seferi Kryqi i Kuq i Kosovës (KKK)
- Driton Selmanaj Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)
- Driton Bajraktari Down Syndrome Kosova (DSK)
- Dionis Licaj Coca-Cola Hellenic
- Faik Hoti Ministria e Shëndetëtisë (MSH)
- Gani Krasniqi Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)
- Gani Lluga ASTRA
- Hajrulla Çeku EC MA NDRYSHE
- Habit Hajredini Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKK)
- Isuf Zeriqi Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)
- Jusuf Thaqi ENCOMPASS
- Kushtrim Kaloshi Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)
- Labinot Krasniqi OJQ KOHA
- Muhamet Arifi Balkan Sunflowers
- Naime Sherifi Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)
- Petrit Tahiri Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
- Petrit Zogaj Lëvizja FOL (FOL)
- Qerkin Berisha Ministria e Financave (MF)
- Rexhep Bllaca Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë (MTI)
- Shqipe Pantina Qendra për Polirika dhe Avokim (QPA)
- Shkumbin Spahija Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC)
- Valdete Idrizi Platforma CIVIKOS
- Valmir Ismajli Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)
- Vjollca Çavolli Asociacioni Kosovar i Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit
- Zef Shala Organizata Humanitare “Nëna Terezë”

## Shtojca 2 – Pyetjet e intervistave

Të gjitha intervistat kanë qenë gjysëm të strukturuar dhe të bazuara në profilin e të intervistuarëve. Janë parashtruar vetëm pyetjet të cilat kanë qenë relevante për të intervistuarit e veçantë, ndërsa me secilin të intervistuar janë diskutuar edhe tema të tjera të fushës.

### Ofrimi i shërbimeve publike

- Cila është korniza ligjore e cila rregullon çështjen e kontraktimit për ofrimin e shërbimeve publike?
- Cila është korniza ligjore e cila rregullon çështjen e kontraktimit të OJQve për ofrimin e shërbimeve publike?
- Kur kontraktoni shërbime, a e përdorni procedurën e njejtë për të gjithë sektorët, apo ka ndonjë procedurë ndryshe për OJQ-të? Cila është procedura përmes së cilës kontraktohet një OJQ për ofrim të shërbimeve publike?
- Në parim, a ja mbulon OJQ-ve të gjitha shpenzimet rreth ofrimit të shërbimeve publike? Pse jo? Obligim i kujt janë shërbimet publike? (Si e vlerësoni konceptin e kontraktimit të OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve publike?)
- Si e siguron cilësinë e shërbimeve të ofruara? A aplikohen këto edhe te OJQ-të dhe ofruesit publik?
- Sa OJQ kanë aplikuar? Sa OJQ janë lincensuar deri më tani? Në cilat fusha? Kush ka vendosur për dhënien e licensave?

### Lehtësirat fiskale për donatorë privatë

- A ka raste kur kompanitë/individët privatë kërkojnë lehtësira fiskale për donacionet e tyre ndaj OJQve? Sa gjatë vitit?
- A gëzojnë lehtësira fiskale? Cilat? A ja vlejné?
- Për cilat qëllime mund të jepen donacionet? Te cilat organizata/subjekte juridike?
- Cila është procedura në të cilën duhet të nënshtrohet një donator në mënyrë që të përfitoj nga lehtësirat e parapara fiskale? Sa zgjat? Na jepni një shembull? Kush merret me këto raste brenda ATK-së?
- A jepni donacione për organizata të shoqërisë civile?
- Në rast të dhënies së donacioneve, a keni lehtësira fiskale nga autoritetet përkatëse?
  - Nëse po, cilat janë ato?
  - A janë të mjaftueshme si incentiva?
  - Cila është procedura që duhet t'i nënshtroheni për të përfituar nga lehtësirat e parapara fiskale (mundësisht të ilustron me një shembull)?

- Dhënia e donacioneve nga kompania juaj, planifikohet paraprakisht apo vendimi merret varësisht prej kërkesave/nevojës (ad hoc)?
  - Aktualisht, a ndikojnë lehtësirat e parapara fiskale në planifikimin tuaj për dhënie të donacioneve?

#### Trajtimi fiskal i aktiviteteve ekonomike të OJQ-ve

- Cka kuptohet me aktivitet ekonomik të OJQ-së?
- A mund të angazhohen OJQ-të në aktivitete ekonomike?
- A ka kufizime në angazhimin OJQ-ve në aktivitete ekonomike? Cilat janë ato?
- Si trajtohen të hyrat nga aktivitetet ekonomike në raport me taksat? A paguhet Tatim në të Ardhura të Korporatave për këto të hyra?
- Si përcaktohen “niveli i arsyeshem i fitimeve të OJQ-së” ose “fitimet e tepruara” – sipas nenit 33.2 të Ligjit për TA Korporatave? Na jepni një shembull?
- Si menaxhohen të hyrat nga aktiviteti ekonomik i OJQ-së?

#### Fondet dhe asetet publike

- Sa lloj procedurash ekzistojnë për shpenzimin e parave nga Buxheti i RKS?
- Në kuadër të ligjeve/procedurave relevante, a ka ndonjë specifike për OJQ-të?
- Cfarë lloj fondesh mund të marrin OJQ-të nga Buxheti i RKS? (kontratat, grantet...)? Si jepen këto fonde? A hapen konkurse publike, apo mund të jepen fonde edhe pa konkurs/tender?
- Cilat kritere zbatohen kur OJQtë aplikojnë për fonde publike?
- Kush e kontrollon zbatimin e kritereve? Si raportohen këto shpenzime? Sa zbatohen kriteret?
- A ka ndonjë listë për OShC-të përfituese? A ka ndonjë statistikë për shumën e fondeve që u janë dhënë OJQ-ve (Qeveria, Ministria)?
- Sa kanë njohuri OShC-të për mundësitë e aplikimit për këto fonde?
- Si raportojnë OJQtë përfituese? Kush e mbikqyr zbatimin e projektit/kontratës? A nënkupton marrja/pranimi i këtyre fondeve/përkrahje edhe varësi të OShC-ve ndaj institucioneve përkatëse?

#### Qytetaria aktive në sistemin e edukimit

- Si trajtohet qytetaria aktive në kuadër të plan programeve shkollore? Në cilin cikël?
- Cfare kualifikimi duhet të kenë mësimmshënësit e këtyre lëndëve? Sa prej tyre e kanë këtë kualifikim në praktikë?
- Kush bën hartimin e teksteve për qytetari aktive?
- A keni konsultuar OJQ-të e specializuara në këtë fushë? Cilat janë ato?

#### Qasja në informata/dokumente zyrtare

- Cilat informata publikohen (pa pasur nevojë për kërkesë)? Cilat informata duhet të publikohen (pa pasur nevojë për kërkesë)? Kush vendos për publikimin e informatave?
- Përvec dokumenteve të klasifikuara, a ka ndonjë lloj tjetër dokumenti i cili mund të mbyllet për publikun?

- Si bëhen kërkesat për qasje (A ekziston ndonjë formular apo secili i interesuar bën kërkesë specifike)? Kush i trajton kërkesat për qasje në dokumente publike? Kush e mbikqyr respektimin e ligjit (përgjigjes, afatit)?
- Cilat janë faqet zyrtare të internetit të Komunave? Ato me rks.net apo faqet e vecanta të secilës Komunë?
- Cilat lloje të informatave jepen më lehtë? Cilat më vështirë?
- A është bërë ndonjëherë kërkesë për qasje në dokumente publike? A ju është siguruar qasja (në kohë)? A është dhënë me shkrim arsyeja e refuzimit? Nëse jo, si keni proceduar më tutje?
- Na thoni ndonjë rast i cili është përcjellur edhe pas monitorimit të problemit/aktivitetit?

#### **Ndikimi i OShC-ve në hartimin e politikave**

- Cfarë lloj kontributi japin OJQ-të në procesin e hartimit të politikave (a është zakonisht kontribut teknik apo përmbajtësor)?
- Si jepen këto kontribute? A dërgojnë OJQ-të kontribute me shkrim, apo vetëm pjesëmarrje në takime?
- Si përzgjedhen OJQ-të që ftohen në takime/grupe të ndryshme (sidomos kur ka numër të kufizuar të vendeve për OJQ)?
- A jepen informata të mjaftueshme paraprakisht, për ta kuptuar përmbajtjen e dokumentit (përvec dokumentit në procedurë, cka tjetër shpërndahet paraprakisht)?
- Cfarë kapacitete duhet të kenë OJQ-të për të kontribu me sukses në hartim të politikave/ligjeve?
- A priten prej OJQ-ve të japin kontribute konkrete (tekste të gatshme për ligje/dokumente) apo vetëm të japin argumente për mundësi/probleme, e këto të përkthehen në “ tekst ligjor” nga shërbyesit civil?

#### **Vullneti politik për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile**

- A jeni të informuar për Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile?
- A keni marrë pjesë në procesin e hartimit të Strategjisë?
- Cilat janë obligimet e institucionit tuaj karshi Strategjisë? A keni filluar përgatitjet për zbatimin e ndonjerit nga këto obligime?
- Si e vlerësoni bashkëpunimin në mes të dy sektorëve? Cka mendoni për palën tjetër?
- A është lëshuar certifikata e Vlerësimit të Ndikimit Financiar për Strategjinë? (ZQM)
- A është bërë zotimi i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e Strategjisë? Nëse jo, pse? Kur pritet të bëhet? (MF)

# Shtojca 3 – Pyetësi i hulumtimit të organizatave

## Pyetësor për organizata të shoqërisë civile

Emri dhe Mbiemri .....

Organizata .....

Adresa.....

Qyteti .....

Kodi postal .....

Email adresa .....

Telefoni .....

P. 1: Në cilin lloj të organizatës e klasifikoni organizatën tuaj

*(ju lutem shënoni vetëm një lloj)*

Organizatë humanitare	1□
Shoqatë e tregtarëve apo afaristëve	2□
Shoqatë profesionale (mjekë, mësues, etj.)	3□
Sindikatë	4□
Grup i lagjes/fshatit	5□
Institut kërkimor/hulumtues (Think-Tank)	6□
Grup i komunitetit etnik	7□
Grup apo shoqatë kulturore (p.sh. art, muzikë, teatër, film) <sup>15</sup>	8□
Shoqatë për shërbime dhe përfshirje sociale (p.sh. shoqatë e personave me aftësi të kufizuara)	9□
Shoqatë sportive <sup>16</sup>	10□
Grup arsimor (p.sh. shoqatë prindër-mësues, komiteti i shkollës)	11□
Organizatë për demokratizim (p.sh. kundër korrupsionit, zhvillim të shoqërisë civile)	12□
Shoqatë e fermerëve apo për zhvillim rural	13□
Organizatë rinore, e studentëve apo e fëmijëve	14□
Organizatë e grave	15□
Organizatë për të drejtat e njeriut apo shërbime ligjore	16□
Organizatë për çështje të nivelit lokal	17□
Organizatë mjedisore	18□
Organizatë për zhvillim ekonomik	19□
Organizatë hobi	20□
Organizatë religjioze <sup>17</sup>	21□

<sup>15</sup> Kjo NUK përfshin vizitat në kinema apo performimin e muzikës me miq.

<sup>16</sup> Kjo NUK përfshin aktivitetet sportive jashtë shoqatës (p.sh. me grup miqsh).

<sup>17</sup> Kjo NUK përfshin komunitetet fetare (p.sh. Bashkësinë Islame, Kishën Katolike, etj.)

## 1. STRUKTURA E SHOQËRISË CIVILE

P. 2: Në cilin vit është themeluar organizata juaj \_\_\_\_\_

P. 3: A është e regjistruar organizata juaj?

Po	1□
Jo	2□

---

Nëse jeni përgjigjur me Jo, kaloni në pyetjen P.5

P. 4: Në çfarë forme është e regjistruar organizata juaj?

Shoqatë (organizatë e antarësisë)	1□
Fondacion (organizatë pa antarësi)	2□

---

P. 5: Cili është organi më i lartë vendim-marrës i organizatës suaj?

Kuvendi i Anëtarëve	1□
Bordi	2□
Tjetër (specifiko) _____	3□

---

P.6: Nëse funksiononi si shoqatë, cili është numri i anëtarëve? \_\_\_\_\_

P. 7: Sa pjesëtarë të personelit janë vullnetarë dhe sa prej tyre marrin paga?

	Numri
Q. 7a – Vullnetarë	_____
Q. 7b – Personel që merr pagë	_____

---

P. 8: Si do ta vlerësonit punën vullnetare në shoqëri civile në përgjithësi, gjatë tre viteve të fundit:

- Në rritje 1□
- Në nivel konstant 2□
- Në rënie 3□



P. 9: Sipas mendimit tuaj, çka ka ndikuar në rritjen e punës vullnetare: (rretho të gjitha ato që aplikohen)

<b>P. 9a: Në rritje</b>	
Rregullimi i punës vullnetare për të rinjë me Ligjin për Rini	1 <input type="checkbox"/>
Përfitimet jo-monetare për vullnetarë	2 <input type="checkbox"/>
Mungesa e vendeve të punës me pagesë	3 <input type="checkbox"/>
Imazhi i mirë i shoqërisë civile	4 <input type="checkbox"/>
Vetëdijësimi në ngritje i popullësisë për punë vullnetare	5 <input type="checkbox"/>
Dëshira për t'i ndihmuar punës së suksesshme të institucioneve përgjegjëse për fusha të caktuara	6 <input type="checkbox"/>
Tjetër (specifiko) _____	7 <input type="checkbox"/>

P. 10: Sipas mendimit tuaj, çka ka ndikuar në rënien e punës vullnetare: (rretho të gjitha ato që aplikohen)

<b>P. 10a: Në rënie</b>	
Mungesa e njohjes së punës vullnetare me ligj	1 <input type="checkbox"/>
Mungesa e përfitimeve jo-monetare për vullnetarë	2 <input type="checkbox"/>
Gjendja e vështirë ekonomike e popullësisë	3 <input type="checkbox"/>
Imazhi jo i mirë i shoqërisë civile	4 <input type="checkbox"/>
Vetëdijësimi i ulët i popullësisë për punën vullnetare	5 <input type="checkbox"/>
Zhgënjimi nga puna e institucioneve përgjegjëse për fusha të caktuara	6 <input type="checkbox"/>

Tjetër (specifiko)	7□
_____	

P. 11: Në përgjithësi, kohëzgjatja e qëndrimit të stafit programor në organizatë është:

- Jo më shumë se 1 vit 1□
- Rreth 2 vite 2□
- 3-5 vite 3□
- Më shumë se 5 vite 4□

P. 12: Në përgjithësi, bazuar në nevojat dhe fushën e veprimtarisë, organizata e ka:

- Shumë të lehtë që të gjejë dhe punësojë staf të përgatitur profesionalisht 1□
- Relativisht të vështirë që të gjejë dhe punësojë staf të përgatitur profesionalisht 2□
- Shumë të vështirë që të gjejë dhe punësojë staf të përgatitur profesionalisht 3□

P. 13: Kur punësoni staf të ri, kriteri kryesor që merrni parasysh është: *(rretho të gjitha ato që aplikohen)*

- Kualifikimi arsimor për fushën përkatëse 1□
- Përvoja e punës në fushën përkatëse 2□
- Referencat nga organizatat/partnerët e besuar 3□
- Tjetër (specifiko)\_\_\_\_\_ 4□

P. 14: Sa është numri i rrjeteve, grupeve ombrellë ose federatave në të cilat organizata juaj është anëtare:

- Asnjë 1□
- 1 2□
- 2 3□
- 3-5 4□
- Më shumë se 5 5□

P. 15: Në 3 muajt e fundit, keni pasur takime ose keni shkëmbyer informata *(p.sh. dokumente, raporte, të dhëna)* me organizata tjera që punojnë në çështje të ngjashme që veprojnë **brenda Kosovës** me *(shëno numrin e organizatave)*:

- Asnjë 1□
- 1 2□

- 2 -5 3☐
- 5-10 4☐
- Më shumë se 10 5☐

P. 16: Në 3 muajt e fundit, keni pasur takime ose keni shkëmbyer informata (*p.sh. dokumente, raporte, të dhëna*) me organizata tjera që punojnë në çështje të ngjashme që veprojnë **jashtë Kosovës** me (*shëno numrin e organizatave*):

- Asnjë 1☐
- 1 2☐
- 2 -5 3☐
- 5-10 4☐
- Më shumë se 10 5☐

a. P. 17: A mendoni që shoqëria civile në Kosovë ka në dispozicion:

	Shumë pak	Mesatarisht	Mjaftueshëm
P.17a: Organizata përkrahëse për ngritje të kapaciteteve të përgjithshme?	1☐	2☐	3☐
P.17b: Trajnime relevante për menaxhim të organizatës?	1☐	2☐	3☐
P.17c: Trajnime specifike për fushat e veprimtarisë	1☐	2☐	3☐
P.17d: Këshilla ligjore dhe praktike rreth çështjeve të funksionimit të organizatës	1☐	2☐	3☐
P.17e: Këshilla ligjore dhe praktike rreth çështjeve specifike për fushat e veprimtarisë	1☐	2☐	3☐

P. 18: Kur jeni regjistruar, sa kohë ju kanë marrë procedurat e regjistrimit:

- Më pak se 2 javë 1☐
- Rreth 1 muaj 2☐
- Rreth 2 muaj 3☐
- Më shumë se 2 muaj 4☐
- Nuk e di 5☐

P. 19: Kur jeni regjistruar, dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- I keni përgatitur vet 1
- I keni shfrytëzuar shabllonet nga Zyra për OJQ 2
- I keni marrë të gatshme nga një OJQ tjetër ekzistuese 3
- Keni kërkuar ndihmë nga persona tjerë 4

P. 20: Në përgjithësi, rregulloret dhe ligjet për shoqërinë civile në Kosovë sipas mendimit tuaj janë:

- |                          |                            |
|--------------------------|----------------------------|
| Tejet kufizuese          | 0 <input type="checkbox"/> |
| Mjaft kufizuese          | 1 <input type="checkbox"/> |
| Mesatarisht të favorshme | 2 <input type="checkbox"/> |
| Plotësisht të favorshme  | 3 <input type="checkbox"/> |
- 

P. 21: A është ballafaquar organizata ndonjëherë me ndonjë kufizim të pa-arsyeshëm apo sulm jo-legjitim nga pushteti lokal apo qendror?

- |    |                            |
|----|----------------------------|
| Jo | 0 <input type="checkbox"/> |
| Po | 1 <input type="checkbox"/> |
- 

P. 22: Nëse po, për çfarë lloj kufizimi apo sulmi bëhet fjalë (sqaroni shkurt):

---

---

P. 23: A keni kontakte me Zyren për Ndërlidhje dhe Regjistrim të OJQ-ve:

- Po, për qëllime bashkëpunimi, me iniciativë të organizatës suaj 1
- Po, për qëllime bashkëpunimi, me iniciativë të Zyres për Ndërlidhje dhe Regjistrim të OJQ-ve 2
- Po, vetëm për çështje zyrtare (regjistrim të OJQ-së, raporte vjetore) 3
- Jo, asnjëherë 4

P. 24: A raportoni rregullisht në Administratën Tatimore të Kosovës:

- Po 1
- Jo 2

Nëse jo, kaloni në pyetjen Q.26

P. 25: Procedurat për raportim në Administratën Tatimore të Kosovës i konsideroni:

- Në përputhje me natyrën e punës së OJQ-së tuaj 1
- Të pranueshme, por jo në përputhje me natyrën e punës së OJQ-së tuaj 2
- Shumë të vështira, në shpërputhje me natyrën e punës së OJQ-së tuaj 3

P. 26: Cilat nga këto i paguani në baza të rregullta? (*rretho të gjitha ato që aplikohen*)

- Tatimin në të ardhura personale 1
- Kontributin pensional të punëtorëve 2
- Tatimin në qira/pronë 3
- Tatimin në të ardhura të korporatave/Tatimin në fitim 4
- Tatimin në Vlerën e Shtuar (TVSH) 5
- Sigurimin shëndetësor të punëtorëve 6

P. 27: Gjatë 3 viteve të fundit, a keni pasur vizita në zyrën tuaj nga inspektorë të Administratës Tatimore të Kosovës:

- Jo, asnjëherë 1
- Po, një herë 2
- Po, disa herë 3
- Po, shumë shpesh 4

---

*Nëse jeni përgjigjur me JO, kaloni në pyetjen P. 29*

P. 28: Gjatë vizitave të tyre, inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës kanë kërkuar nga ju (*rretho të gjitha ato që aplikohen*):

- Dokumentet dhe dëshmitë rreth pagesës së taksave 1

- Dokumentet financiare të organizatës suaj që nuk kanë të bëjnë me taksa 2☐
- Informata dhe dokumente rreth programit të punës dhe aktiviteteve të organizatës 3☐
- Tjetër: \_\_\_\_\_ 4☐

P. 29: Bazuar në vitin e kaluar financiar, çfarë përqindje e burimeve financiare të organizatës suaj kanë ardhur prej burimeve në vijim (shënoni përqindjen e burimeve totale në kllapa)? **(ju lutem keni parasysh që shuma e përgjithshme për burimet e ndryshme financiare nuk duhet të kaloj 100%)**

P. 29a: Institucionet shtetërore qendrore	[----- %]
P. 29b: Institucionet shtetërore lokale	[----- %]
P. 29c: Kompani private vendore	[----- %]
P. 29d: Donatorët e huaj	[----- %]
P. 29e: Donacionet individuale vendore	[----- %]
P. 29f: Tarifat e anëtarësimit	[----- %]
P. 29g: Tarifat / shitjet e shërbimeve	[----- %]
<hr/>	
P. 29h – Tjera (ju lutem sqaroni):	[----- %]
<hr/>	
<b>TOTAL</b>	<b>[100%]</b>
<hr/>	

P. 30: A keni përfituar ndonjëherë nga fondet e Bashkimit European?

- Po 1☐
- Jo 2☐

P. 31: Cila nga kategoritë e mëposhtme do të përshkruante më së miri të hyrat vjetore të organizatës suaj gjatë vitit të fundit:

- Më pak se 10,000 EUR në vit 1☐
- 10,000 – 50,000 EUR në vit 2☐

- 50,000 – 100,000 EUR në vit 3
- 100,000 – 500,000 EUR në vit 4
- 500,000 – 1,000,000 EUR në vit 5
- Mbi 1,000,000 EUR në vit 6

P. 32: Krahasuar me vitin e kaluar, **të ardhurat** e organizatës tuaj a janë...

- |                  |                            |
|------------------|----------------------------|
| rritur           | 1 <input type="checkbox"/> |
| ngelur të njëjta | 2 <input type="checkbox"/> |
| zvogëluar        | 3 <input type="checkbox"/> |
- 

P. 33: A keni pranuar ndonjëherë ftesë për t'u konsultuar rreth programimit të fondeve të ndonjë donatori të caktuar?

- Po 1
- Jo 2

P. 34: Nëse jeni përfshirë në konsultime rreth programimit të fondeve të donatorëve, a keni vërejtur që kontributi juaj është marrë parasysh?

- Aspak 1
- Shumë pak 2
- Mesatarisht 3
- Plotësisht 4

P. 35: Çfarë lloji të përkrahjes keni pranuar nga donatorët gjatë 3 viteve të fundit: *(rretho të gjitha ato që aplikohen)*

- Grante për projekte 1
- Grante institucionale 2
- Kontrata për shërbime 3
- Asistencë teknike 4

P. 36: Gjatë 3 viteve të fundit, a keni pranuar donacione nga persona privat në Kosovë?

- Po 1
- Jo 2

Nëse JO, kalo në pyetjen P. 38

P. 37: Cila ka qenë arsyeja për dhurimin e donacioneve nga personat privat në Kosovë? *(rretho të gjitha që aplikohen)*

- Lehtësirat tatimore për shumën e dhuruar 1
- Përkrahja për çështjen/projektin/aktivitetin konkret 2
- Përkrahja për organizatën tuaj 3



- Ngritja e imazhit publik të personit dhurues 4□
- Tjetër (*specifiko*): \_\_\_\_\_ 5□

P. 38: Gjatë 3 viteve të fundit, a keni pranuar donacione nga kompani private në Kosovë?

- Po 1□
- Jo 2□

Nëse JO, kalo në pyetjen P. 40

P. 39: Cila ka qenë arsyeja për dhurimin e donacioneve nga kompanitë private në Kosovë? (*rretho të gjitha që aplikohen*)

- Lehtësirat tatimore për shumën e dhuruar 1□
- Përkrahja për çshtjen/projektin/aktivitetin konkret 2□
- Përkrahja për organizatën tuaj 3□
- Ngritja e imazhit publik të kompanisë dhuruese 4□
- Tjetër (*specifiko*): \_\_\_\_\_ 5□

P. 40: Gjatë 3 viteve të fundit, cilat lehtësira i ka përfituar organizata juaj? (*rretho të gjitha që aplikohen*)

- Lirim nga tatimi në të ardhura të korporatave/Tatimin në fitim 1□
- Lirim nga tatimi në qira/pronë 2□
- Lirimi nga tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH) 3□
- Lirimi nga taksat doganore 4□
- Fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës 5□
- Dhënie në pronësi apo shfrytëzim të objekteve në pronësi publike/shtetërore 6□
- Shfrytëzim pa pagesë të objekteve/hapësirave në pronësi publike/shtetërore për aktivitete të caktuara 7□
- Asnjë nga opcionet e shënuara më lartë 8□
- Tjetër (*specifiko*): \_\_\_\_\_ 9□

P. 41: Gjatë 3 viteve të fundit, a ka pasur organizata juaj Status për Përfitim Publik?

- Po 1□
- Jo 2□

P. 42: Gjatë 3 viteve të fundit, a keni pranuar fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës?

- Po 1□
- Jo 2□

P. 43: Cilat kanë qenë shumat **për një projekt** të financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës gjatë 3 viteve të fundit: (*rretho të gjitha që aplikohen*)

- |                      | <i>Niveli qendror</i> | <i>Niveli lokal</i> |
|----------------------|-----------------------|---------------------|
| • Deri në 10,000 EUR | 1□                    | 1□                  |

- Deri në 25,000 EUR 2  2
- Deri në 50,000 EUR 3  3
- Deri në 100,000 EUR 4  4
- Më shumë se 100,000 EUR 5  5

P. 44: Fondet e pranuar nga buxheti i Republikës së Kosovës gjatë 3 viteve të fundit, i keni fituar:  
(rretho të gjitha ato që aplikohen)

- Bazuar në thirrje të hapur për aplikim 1
- Bazuar në ftesë të drejtëpërdrejt nga institucionet publike për të aplikuar 2
- Bazuar në kontakte të drejtëpërdrejta me institucionet publike 3
- Tjetër (specifiko): \_\_\_\_\_ 4

P. 45: Cili nivel i qeverisjes është në fokusin kryesorë të punës së organizatës suaj:

- Fshati/qyteza specifike 1
- Komuna specifike 2
- Një numër i madh komunash 3
- Ministrinë dhe qeveria qendrore 4
- Kuvendi i Kosovës 5

P. 46: Në 3 vitet e fundit, a ka pasur organizata juaj qasje të mjaftueshme në informatat e institucioneve publike që kanë qenë relevante për punën tuaj?

- Nuk ka pasur fare qasje në informata 1
- Ka pasur qasje të kufizuar në informata 2
- Ka pasur qasje të mjaftueshme në informata 3
- Ka pasur qasje të pakufizuar në informata 4

P. 47: Në 3 vitet e fundit, a ju është refuzuar ndonjë kërkesë për qasje në informata të institucioneve publike?

- Po, na janë refuzuar shumica e kërkesave 1
  - Na janë refuzuar vetëm disa kërkesa 2
  - Për shumicën e kërkesave është vonuar përgjigja 3
  - Jo, nuk na është refuzuar asnjë kërkesë 4
  - Nuk kemi bërë asnjëherë kërkesë për informata 5
-

P.48: Gjatë 3 viteve të fundit, a është ftuar organizata juaj në ndonjë konsultim publik nga autoritetet publike (*takim konsultativ, konsultim me shkrim, tryezë diskutimi, etj.*)

- Është ftuar rregullisht, sa herë që ka pasur çështje relevante për punën tonë 1
  - Është ftuar vetëm kohë pas kohe 2
  - Është ftuar shumë rrallë 3
  - Nuk është ftuar asnjëherë 4
- 

P. 49: Çfarë ndikimi mendoni që ka **shoqëria civile në përgjithësi** në hartimin e politikave publike ose ligjeve në vendin tuaj?

- Nuk ka fare ndikim 0
  - Ka ndikim të kufizuar 1
  - Ka ndikim të ndjeshëm 2
  - Ka nivel të lartë të ndikimit 3
- 

P. 50: Në 3 vitet e fundit, a është angazhuar organizata e juaj në hartimin dhe miratimin e ndonjë politike publike, ligji apo rregullore komunale?

- Po 1
  - Jo 2
- 

P. 51: Në përgjithësi, cili ka qenë rezultati i angazhimit tuaj për këto politika/ligje?

Kontributet tona janë refuzuar plotësisht	Shumica e kontributeve tona është refuzuar	Shumica e kontributeve tona është pranuar	Kontributet tona janë pranuar plotësisht
1 <input type="checkbox"/>	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>

P.52: Në rastet kur kontributet tuaja janë refuzuar, a keni pranuar ndonjëherë me shkrim arsyet e refuzimit?

- Asnjëherë 1
- Vetëm disa herë 2
- Në shumicën e rasteve 3
- Gjithmonë 4

P. 53: Sa shpesh keni komunikim (*shkëmbim informatash, takime, aktivitete të përbashkëta*) me institucionet publike relevante për punën tuaj:

- Asnjëherë 1
- Shumë rrallë 2
- Mesatarisht shpesh 3
- Shumë shpesh 4

P. 54: A ofron organizata juaj shërbime për qytetarët ose grupet e caktuara të qytetarëve?

- Po 1
- Jo 2

---

(Nëse jeni përgjigjur me Jo, kaloni në pyetjen P. 58)

P. 55: Çfarë lloj shërbimesh ofron organizata juaj? (*zgjedhni përgjigjen më të saktë*)

- Shërbime sociale 1
- Shërbime shëndetësore 2
- Shërbime në fushën e arsimit/edukimit 3
- Shërbime ligjore 4
- Tjetër (specifiko) \_\_\_\_\_ 5

P. 56: Organizata juaj shërbimet i ofron:

- Falas 1
- Me pagesë simbolike, me çmim më të lirë se ai i tregut 2
- Me pagesë të plotë 3

P. 57: Shpenzimet për ofrimin e shërbimeve organizata juaj i mbulon nga:

- Fondet nga donatorët ndërkombëtarë 1
- Fondet nga donatorët privat vendorë 2
- Fondet publike 3
- Pagesa e shërbimeve nga klientët 4

## 2. AMBIENTI I JASHTËM

P. 58: Sipas mendimit tuaj, ambienti i përgjithshëm shoqëror, politik dhe ekonomik në Kosovë:

- E pengon zhvillimin e shoqërisë civile 1
- Nuk ndikon fare në zhvillimin e shoqërisë civile 2

- E ndihmon zhvillimin e shoqërisë civile 3□

P. 59: Sipas mendimit tuaj, cila është pengesa më e madhe në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë (nga faktorët jashtë shoqërisë civile):

- Mungesa e sundimit të ligjit 1□
- Problemet në zhvillimin ekonomik 2□
- Niveli jo i kënaqshëm i edukimit të popullësisë 3□
- Mungesa e kuptimit të rolit të shoqërisë civile nga popullësia 4□
- Mungesa e njohjes së plotë ndërkombëtare të Kosovës 5□
- Mungesa e besimit në ndryshim nëpërmjet angazhimit 6□
- Financimi joadekuat 7□
- Tjetër (specifiko) \_\_\_\_\_ 8□

P. 60: Sipas mendimit tuaj, cili është imazhi i shoqërisë civile në publikun e gjërë:

- I mirë 1□
- Mesatar 2□
- I keq 3□

P. 61: Puna dhe ndikimi i organizatave të shoqërisë civile në përgjithësi, nga publiku i gjërë:

- Mbivlerësohet 1□
- Vlerësohet realisht 2□
- Nënvlërësohet 3□

P. 62: Puna e organizatave të shoqërisë civile në përgjithësi, brenda rrethanave aktuale socio-kulturale nga publiku:

- Përkrahet 1□
- Nuk përkrahet 2□
- Pengohet 3□